



NJË UDHËZUES PËR TË BËRË BIZNES ME BE

Udhëzues për Dhomat e Tregtisë dhe organizatat mbështetëse të biznesit që kërkojnë informacion objektiv rreth të bërit biznes me Bashkimin Europian.

Përgatiti: Delina Nano

Nëntor 2012



Ky publikim u botua me mbështetjen financiare të Komisionit Europian.

Përmbajtje

Hyrja

1. Informacion i përgjithshëm rreth Bashkimit European

- 1.1. Institucionet dhe politikat europiane
- 1.2. Informacion dhe këshillim për bizneset – Rrjeti European i Ndërmarrjeve (EEN)

2. Importimi i mallrave në / nga Bashkimi European

- 2.1. Numrat e kodeve doganore dhe detyrat e importit
- 2.2. Dokumentat doganore
- 2.3. Kuotat tarifore të importit
- 2.4. Matjet antii-damping
- 2.5. Rregullat e origjinës
- 2.6. Lejet e importit për tekstiket dhe çelikut
- 2.7. Doganat dhe siguria
 - 2.7.1. AEO – Operatori Ekonomik i Autorizuar
 - 2.7.2. EORI – Rregjistrimi i Operatorëve Ekonomikë dhe Numri i identifikimit
 - 2.7.3. Transferimet e mallrave me përdorim të dyfishtë ndërmjet vendeve të BE
- 2.8. Tregu Ndërkombëtar i Qëndrueshëm

3. Taksimi i mallrave në Bashkimin European

- 3.1. Taksa e Vlrës së Shtuar (TVSH)
- 3.2. Detyrimet indirekte

4. Prodhimi dhe/ose shitja e mallrave dhe shërbimeve në Bashkimin European

- 4.1. Rregullat e tregut të brendshëm në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave
 - 4.1.1. Produktet industriale të mbuluara nga trajtimi i ri (shenja CE) në harmonizimin teknik
 - 4.1.2. Artikujt ushqimorë
 - 4.1.3. Produktet kimike
 - 4.1.4. Produktet e tjera

4.2. Rregullat mjedisore për tregtimin e mallrave në Bashkimin European

4.2.1. Ambalazhimi dhe detyrimet e plehrave ambalazhuese

4.2.2. Pajisje elektrike dhe elektronike: WEEE dhe ROHS

4.3. Çështjet mjedisore në menaxhimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, projektimin dhe prodhimin e mallrave

4.3.1. EMAS - Eko-Menaxhimi dhe Skema e Audiit

4.3.2. Skemat e eko-etiketimit për produktet industriale

4.3.3. Eko-projektimi për produktet që përdorin energji

4.4. Rregullat e tregut të brendshëm në lidhje me lirinë e sigurimit të shërbimeve në Bashkimin European

4.4.1. Direktiva e Shërbimeve Europiane

4.4.2. Njoftimi i Direktivës së Punonjësve

5. Të drejtat e pronësisë intelektuale në Bashkimin European

5.1. Mbrojtja e patentave në BE

5.2. Mbrojtja e shenjave dalluese në BE

5.3. Mbrojtja e modeleve dhe projekteve në BE

6. Gjetja e partnerëve të biznesit në Bashkimin European

6.1. Publikimi i propozimeve të tregtisë dhe bashkëpunimit në BE

6.2. Gjetja e partnerëve R&D në Europë

7. Fillimi i një biznesi në Bashkimin European

7.1. Kërkesat dhe iniciativat ligjore për krijimin e një shoqërie në BE

7.2. Sistemet e sigurimit social në BE

7.3. Taksimi në Shtetet Anëtare të BE

8. Informacioni i tregut

8.1. Informacioni statistikor rreth tregut të jashtëm të BE

8.2. Panairët tregtare në BE (dhe në mbarë botën)

9. Aspektet ligjore (kontraktuale) të bërjes biznes me BE

9.1. Kontratat me ndërmarrjet e BE

9.2. Incoterms

9.3. Listat përmbledhëse të dokumentave

9.4. Faturimi elektronik

10. Mundësitë e tregjeve publike në Bashkimin Europian

10.1 Tenderat dhe grantet Europiane

10.2. Prokurimi Publik në BE

11. Euro

11.1. Kursi i këmbimit të huaj Euro

11.2. Pagesat ndërkufitare në euro

12. Informacione të tjera

12.1. Identifikimi i bar-kodeve në Shtetet Anëtare të BE

12.2. Identifikimi i Numrave Globalë të Vendosijes (GLN)

13. Zgjidhja e problemeve në bërjen biznes në BE

13.1. SOLVIT: një shërbim i orientuar drejt zgjidhjes për bizneset

14. Kontakt

Hyrje

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe shoqëritë e mëdha brenda dhe jashtë Bashkimit European kanë nevojë rregullisht të grumbullojnë informacion përkatës të posaçëm për veprimet e biznesit të tyre brenda dhe me shoqëritë në BE.

Shoqëritë që importojnë mallra në BE duhet të dinë numrat e kodit të produktit për produktet e tyre dhe listën e dokumentave të importit që duhet të paraqiten pranë autoriteteve të doganave. Mund të jetë e dobishme për ta të verifikojnë aplikohen tarifa doganore të favorizuara të importit dhe të identifikohen se cilat rregulla të origjinës janë në fuqi. Taksat e brendshme në Shtetet Anëtare të BE si TVSH dhe detyrimet e akcizës është gjithashtu e nevojshme të njihen mire nga bizneset. Para importimit të mallrave në BE, importuesit kanë nevojë gjithashtu të dinë rregullat teknike, të etiketimit dhe ambalazhimit, kërkesat higjienike ose rregullat mjedisore për mallrat të cilat do të shiten në tregun e brendshëm të Bashkimit European.

Dhomat e Tregtisë apo organizatat që mbështesin biznesin janë të interesuara të ofrojnë një sërë informacioni mbi tregun, p.sh. statistikave rreth eksportimeve dhe importimeve të mallrave të caktuara apo të dhëna praktike rreth panairëve ndërkombëtar në sektor të ndryshëm. Ata mund të jenë në kërkim të partnerëve të biznesit dhe mënyrave për të promovuar tregtinë e tyre dhe propozimet e bashkëpunimit në Shtete të ndryshme anëtare të BE apo në kërkim të teksteve model për kontratat në tregun ndërkombëtar.

Ky udhëzues përpiqet të drejtojë përdoruesin në burimet e përshtatshme të informacionit ku mund të gjenden përgjigje konkrete në fushat e përshkruara më lart.

Përdoruesit mund të zgjedhin nga përmbajtjet ato tema të cilat janë të rëndësishme për ta. Udhëzuesi shpjegon shkurtimisht cilat burime informacioni ofrojnë informacion në një fushë të caktuar dhe jep të dhëna praktike rreth këshillimit të shumë faqeve interesante në internet.

Ky Udhëzues u realizua me mbështetjen financiare të Komisionit European. Qëllimi ishte të krijojë për organizatat mbështetëse të biznesit dhe ndërmarrjet individuale në Shqipëri një mënyrë të qëndrueshme për identifikimin dhe ofrimin e informacionit mbi BE për biznesin.

Të gjithë përdoruesit janë të mirëpritur të dërgojnë sugjerimet e tyre për përmirësimin e këtij Udhëzuesit. Këto komente të çmuara do të përpunohen dhe reflektohen në vazhdim.

Ndërkohë, ne i urojmë të gjithë përdoruesve një përdorim efikas të këtij “Udhëzuesi”!

1. Informacion i përgjithshëm rreth Bashkimit European

1.1. Institucionet dhe politikat europiane.

1.2. Informacion dhe këshillim për bizneset:

**Rrjeti European i Ndërmarrjeve
(Enterprise Europe Netëork - EEN)**

1.1. INSTITUCIONET DHE POLITIKAT EUROPIANE

Bashkimi European përfaqëson shumicën e vendeve dhe qytetarëve Europeanë. Ai është një organizim pothuaj shtetëror, nisur nga fakti se ka marrë përsipër një pjesë të mirë të sovranitetit të shteteve anëtare.

Arsyeja e ekzistencës së Bashkimit European: – **t'i bëjë Europeanët të begatë dhe paqësorë** – të udhëhiqet drejt tregtisë së lirë brenda kufijve të tij. Me produktet që qarkullojnë gjerë e më gjerë, u pa që Europeanët po bëheshin në mënyrë reciproke gjithnjë e më kurioz, të hapur dhe miqësorë. Besimi i akumuluar nga kjo përvojë i frymëzoi aktorët e BE të shtrijnë dhe intensifikojnë bashkëpunimin European dhe të flasin me një zë të fortë për tregtinë e lirë në mbarë botën.

Institucionet kryesore të BE mund të kategorizohen në:

- qeveritare: [Komisioni European](#)
- përfaqësuese: [Parlamenti European](#) (qytetarët) dhe [Këshilli i Bashkimit European](#) (shtetet anëtare)
- gjyqësore / të auditit: [Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane](#)
[Gjykata Europiane e Auditorëve](#)

Gjithashtu shumë i dukshëm është [Këshilli Europes](#), një takim një herë në tri muaj i Shteteve Anëtare që sjell së bashku presidentët kombëtarë, kryeministrat dhe Presidentin e Komisionit. Ai përkrah të gjithë politikën dhe progresin European.

Organe të tjera të BE me një rol të veçantë janë:

- [Komiteti European Ekonomik e Social](#)
- [Komiteti i Rajoneve](#)
- [Banka Qendrore Europiane](#)
- [Avokati i Popullit European](#)

Stafi i Komisionit, Parlamentit dhe Këshillit janë të organizuar në **Drejtori të Përgjithshme** (DGs). Secila Drejtori i Përgjithshme DP kryesohet nga një Drejtor i Përgjithshëm, që i raporton një anëtar mbikqyrës të Komisionit. Së bashku ata janë aktivë në më shumë sesa 30 **fusha të politikës**. Fushat më të përshtatshme të politikës për këtë udhëzues janë: tregtia e jashtme, doganat, sistemi i taksimit, tregu i brendshëm, mbrojtja e konsumatorit dhe mjedisi.

[EUROPA](#), Faqja portale e internetit e BE-së ju fton të takoheni me të gjithë lojtarët dhe aktivitetet e BE. Për lehtësinë tuaj, ju prezantojmë një **manual referimi të lehtë**.

Burim informacioni 1: Një shikim i shpejtë mbi BE

Faqja e internetit: http://europa.eu/abc/index_en.htm



Hidhuni nga pika në pikë në këtë ‘**ABC të Europës**’ për të zbuluar një [panoramë](#), the [simbolet](#), [vendet](#), dhe [faktet kryesore](#). Mos e anashkaloni [udhëzues për Eurozhargonin](#). Ajo hedh dritë mbi termat më të errët të BE si “Këshill”, “vend i tretë” dhe “subsidiaritet”.

Si të gesh informacion në këtë ‘ABC të Europës’

Hapi 1: futu në ‘ABC’ (kliko në [linkun](#) e mësipërm)

Hapi 2: lëvizni mausin tuaj tek një [ikonë](#) që jep një shpjegim të shkurtër të temës ... dhe kliko

Burim informacioni 2: Pasqyrë e politikave

Faqja e internetit: http://europa.eu/pol/index_en.htm

Nëse ju dëshironi të hidhni një shikim të shpejtë në një nga 32 fushat e **aktivitetit të BE-së**, ndiqni hapat.

Hapi 1: futuni në ‘vështrim i përgjithshëm’ (kliko në [linkun](#) e mësipërm)

Hapi 2: zgjidhni politikën tuaj të interesit dhe klikoni

Për **legjislacionin** apo për **faqen kryesore të një legjislacioni** në lidhje me politikën e interesit tuaj, ndiqni shembujt.

Shembulli 1:

“Po kërkoj faktet e fundit të Drejtorisë së Përgjithshme DP të Tregut të jashtëm.”

Hapi 1: futu tek ‘vështrim i përgjithshëm’ (kliko në linkun e mësipërm) dhe kliko në “Marrëdhëniet e jashtëme”

Hapi 2: kliko në ‘Më shumë informacion’

Hapi 3: kliko në “Komisioni – Tregtia e Jashtëme”

Tani ju keni arritur në faqen kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme DP të tregtisë së jashtëme. Të rejat më të fundit shfaqen në pikën e saj qendrore.

Shembulli 2: “Po kërkoj informacion mbi të drejtat anti-damping të tregtisë së jashtëme për llampat ndërmjet BE dhe Kinës.”

Hapi 1: ndiq hapin 1 deri 3 të shembullit 1

Hapi 2: klik mbi “Dokumentat dhe publikimet”

Hapi 3: fut “Lista e masave anti-damping” në kutinë “Kërkim dokumenti – Fjalët kyçe opsionale” ‘Document search – Keyword(s) optional’

Tani ju mund të hapni dokumentin në Excel ‘[Lista e masave anti-damping dhe anti-subvencionim](#)’ dhe verifiko në listën alfabetike të produkteve, informacioni mbi të cilat është ende i vlefshëm në lidhje me taksat doganore anti-damping për llampat nga Kina.

Burim Informacioni 3: Kanalet për pyetjet e përgjithshme

Faqja e internetit: http://europa.eu/geninfo/mailbox/index_en.htm

Merrni një turne **zbulimi të ndihmuar personalisht** me telefon, direkt online, ose me e-mail. Ndiqni hapat.

Hapi 1: login (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: zgjidh kanalin më të përshtatshëm

Mundësia 1: klik në “Europa drejtpërdrejt” [‘Europe Direct’](#) nëse ju keni një pyetje të përgjithshme mbi BE

Mundësia 2: kliko në “ndihma në rrjet” [‘ëeb assistance’](#) Nëse keni nevojë për ndihmë duke naviguar nëpër EUROPA

Mundësia 3: klik në [‘Udhëzues kontakti me institucionin, organin dhe Agjencinë Europiane’](#) për t’i dërguar një e-mail një institucioni apo organi European

Hapi 3: telefono, ose postojë në një adresë të zgjedhur kontakti.

A. Shënim mbi gjuhët

BE dëshiron t’ju pajisë me informacion në një gjuhë të njohur. BE tani përllogarit 23 gjuhë zyrtare. Tri gjuhët aktuale të brendshme të punës në BE janë Anglishtja, Frëngjishtja dhe Gjermanishtja.

1.2. INFORMACION DHE KËSHILLIM PËR BIZNESET – RRJETI EUROPIAN I NDËRMARRJEVE (EEN)

Rrjeti European i Ndërmarrjeve **Enterprise Europe Netëork**, i lançuar në shkurt 2008, synon të ndihmojë Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme për të zhvilluar potencialin e tyre dhe për të rritur njohjen e tyre me politikat e Komisionit.

Duke u ngritur mbi fuqitë dhe arritjet e Qendrave Europiane të Informacionit dhe Qendrave të Risive të Transmetimit, kjo iniciativë e Komisionit European i ofron sipërmarrësve një one stop shop ku ata mund të kërkojnë këshillim dhe përfitim nga një shkallë e gjerë shërbimesh që mbështesin biznesin që përdoren lehtësisht me qëllim që të marrin njohuri mbi ekonominë.

Bizneset e vogla, veçanërisht në hapat e tyre të para, shpesh nuk kanë burime për të monitoruar nga afër lloje të shumta të ndryshme të asistencës që programet e BE mund të sigurojnë. Dhe jo gjithmonë ata janë në gjendje të vlerësojnë plotësisht potencialin novator dhe atë të tregut të produkteve të tyre apo të eksplorojnë mundësi të reja biznesi, veçanërisht jashtë fushave që ata i njohin mirë.

Rrjeti European i Ndërmarrjeve ngre ura lidhëse për këtë boshllëk. Me më shumë sesa 580 pika kontakti në 45 vende, rrjeti është më i madhi në Europë që siguron ekspertizë dhe shërbime për biznesin. Këto janë të vlefshme për shoqëritë e të gjitha madhësive pavarësisht nga fakti nëse ato janë tek prodhimi apo shërbimet, megjithëse ato janë të drejtuara kryesisht tek Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, institutet e kërkimit, universitetet, qendrat e teknologjisë dhe binzeshi si dhe agjencitë e risive të zhvillimit.

Kërko faqen e Rrjetit European të Ndërmarrjeve në:

http://ëëë.enterprise-europe-Netëork.ec.europa.eu/index_en.htm

Shiko [videoclip](#)



Cilët janë partnerët shqiptar të EEN?

Duke filluar nga 2012 Shqipëria u pranua si anëtare e Rrjetit EEN përmes një konsorciumi të përbërë nga 4 organizata, të cilat janë:

Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë – uccial.al

AIDA – aida.gov.al

AKTI – akti.gov.al

RBA - <http://ëëë.rdatirana.al/>

Faqja internet e konsorciumit shqiptar: <http://een.al>

‘Çfarë mund të bëjnë për mua anëtarët e EEN?’

Anëtarët e EEM në përgjithësi mund t’ju ndihmojë në një nga tri mënyrat. Shembujt e pyetjeve sqarojnë secilën fushë aktiviteti.

Fusha 1: Ju informon mbi çështjet e BE

Shembuj

- ‘Cili është legjislacioni i fundit mbi nivelet maksimale të zhurmës për prodhimin?’
- ‘A duhet të vendos shenjën e CE mbi produktet e mia?’
- ‘A ekziston ndonjë ndihmë financiare në dispozicion për të ndihmuar blerjen e makinerive të reja apo për të bërë një studim realizueshmërie për një sipërmarrje të përbashkët? Si mund të mbështesë BE risinë time dhe investimet e R&D?’
- ‘Çfarë standartesh sigurie ekzistojnë për makinerinë time?’
- ‘Kur mund të vendos “etiketën ECO” mbi produktet e mia?’
- ‘Sa taksa doganore importi duhet të paguhen për verën e importuar në BE nga Kili?’

Fusha 2: Ju këshillon dhe ndihmon

Shembuj

- ‘Kam nevojë për këshillim mbi prokurimin publik, bashkëpunimin e biznesit, financimin, kërkimit e tregut dhe legjislacionin European, ...’
- ‘Kam nevojë për ndihmë të aplikoj për projektet e Komisionit dhe të plotësoj formalitetet administrative, ...’
- ‘Kam nevojë për ndihmë në identifikimin e partnerëve potencialë të biznesit në vende të tjera Europiane, panaire interesante tregtare në degën time, ...’

Fusha 3: Konsolidon zërin tuaj në BE

Shembull

- ‘Dëshiroj t’i jap një informacion konfidencial Komisionit rreth pengesave periodike që paraqiten ndaj ndërmarrjes sime dhe biznesit në përgjithësi.’



Rrjeti European i Ndërmarrjeve Enterprise Europe Netëorë bashkëfinancohet nga buxheti i BE sipas Programit të Sipërmarrjes dhe Inovacionit (EIP) Brenda Programit të Kuadrit të Konkurrencës dhe Inovacionit (CIP). Buxheti ynë është €320 milionë për periudhën 2007–13. Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit [CIP ëebsite](http://cip.eebsite).

2. Importimi i mallrave në / nga Bashkimi European

- 2.1. Numrat e kodit të produktit dhe taksat doganore të importit**
- 2.2. Dokumentat e doganës**
- 2.3. Kuotat tarifore të importit**
- 2.4. Masat anti-damping**
- 2.5. Rregullat e origjinës**
- 2.6. Liçensat e importit për tekstile dhe çelik**
- 2.7. Doganat dhe siguria**
 - 2.7.1. AEO – Operatori Ekonomik i Autorizuar**
 - 2.7.2. EORI – Rregjistrimi i Operatorëve Ekonomikë dhe Numri i Identifikimit**
 - 2.7.3. Transferimet e mallrave me përdorim të dyfishtë ndërmjet vendeve anëtare**
- 2.8. Treg i Qëndrueshëm Ndërkombëtar**

2.1. NUMRAT E KODIT TË PRODUKTIT DHE TAKSAT DOGANORE TË IMPORTIT

‘Si eksportues nga jashtë BE, dëshiroj të eksportoja mallra për në BE.’

‘Si importues, i vendosur në një Shtet Anëtar, dëshiroj të importoj mallra në BE.’

‘Ku mund të gjej informacion rreth numrave të kodeve doganore për produktet dhe tarifatat e taksave doganore korresponduese të importit?’

Për një përgjigje për këto pyetje, shikoni dy faqet e internetit të paraqitura më poshtë.

Burim informacioni 1: baza e të dhënave **TARIC e Komisionit Europian**

Faqja e internetit:

http://ec.europa.eu/taxation_customs/dds/tarhome_en.htm

Për të gjetur informacion në bazën e të dhënave TARIC ndiqni shembullin.

Shembull: Cili është kodi doganor për mobiljet e kuzhinës prej druri?

Cila është taksë doganore e importit që duhet të paguhet për importet në BE për mallrat e prodhuara në Moldavi?

Hapi 1: futu në faqen kryesore [TARIC Home Page](#)

Hapi 2: kërkoni kodin përkatës doganor (= kodi Taric) në një nga dy mënyrat

1. nëpërmjet funksionit broëse (kullot) (= një kërkim nëpër një listë hierarkike) ose
2. nëpërmjet funksionit të kërkuar të avancuar (= një kërkim nëpërmjet një përshkrimi të produktit)

Mundësia 1: kërkimi i një kodi produkti nga lista hierarkike

- kliko në ‘broëse’ me qëllim që të arrish në tabelën Taric të Përmbajtjeve
- zgjidh “seksionin XX artikuj të prodhuar të përzier”
- zgjidh ‘kapitulli 94 Mobilje ...’
- zgjidh ‘9403 Mobilje të tjera dhe pjesë të tyre

- zgjidh '9403 40 Mobilje druri të një lloji të përdorur në kuzhinë'
- zgjidh '9403 40 10 Njësi pajisje kuzhine'
- zgjidh '9403 40 10 90'
- konsultohu me informacionin e tarifave të importit për këtë product me Shqipërinë si vend të origjinës

Mundësia 2: kërkimi i kodit të një produkti nëpërmjet përshkrimit të një produkti

- kliko në “kërkim i avancuar”
- fut një përshkrim përkatës të produktit tuaj (p.sh. “kuzhinë” ose “mobilje”)
- fut ‘kuzhine’ sipas ‘Kërko tekst’ dhe ‘Shqipëria’ sipas ‘Vendi i origjinës’ dhe kliko mbi ‘Tërhiq masat’
- zgjidh '9403 40 10 90' nga lista e paraqitur
- këshillohu me informacionin e tarifave të importit për këtë product me Shqipërinë si vend të origjinës

Burim Informacioni 2: Tryezë pune Export Helpdesk për vendet në zhvillim (Tarifet e importit)

Faqja e internetit: <http://exporthelp.europa.eu/>



Për të gjetur informacion në Tryezën e punës të eksportit ndiq hapat.

Hapi 1: futu në helpdesk tryezën e punës (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: shko tek *Formulari i Futjes së Tarifave të Importit, Import Tariffs Input Form* duke klikuar mbi “Tarifat e Importit” [‘Import Tariffs’](#)

Hapi 3: Në këtë formular, fut:

- a) kodin e një produkti (or find it via ‘broëse’ or ‘search’)
- b) një vend të origjinës (i cili nevojitet për tarifat preferenciale)
- c) një datë simulimi (ju mund të ktheheni mbrapsht deri në 1 Janar 2002)

Hapi 4: kliko ‘shfaq’

Këtu ju gjeni çmimet e duhura të taksave doganore të importit dhe komentet.

Hapi opsional: lexo Guidën e Përdoruesit të Tryezës së punës të detajuar [Helpdesk's User Guide](#), seksioni i “tarifave të importit”

Burim informacioni shtesë: ‘Informacion i tarifës detyruese’ shërbimi (BTI)

Faqja e internetit:

http://ec.europa.eu/taxation_customs/common/databases/ebti/index_en.htm

Nëse keni ende dyshime rreth klasifikimit të saktë të tarifave, autoritetet doganore të Shteteve Anëtare mund t’ju pajisin me një të tillë që është ligjërish i detyrueshëm. Në përgjithësi është pa pagesë, por duhet të përputhet me kushte të caktuara.

Hapi 1: lexo informacion i përgjithshëm [General Information](#) (kliko)

Hapi 2: printo dhe plotëso formularin e aplikimit [application form](#) (click)

Hapi 3: dërgoje tek një nga autoritetet kompetente të doganës [customs authorities](#) (kliko)

2.2. DOKUMENTAT E DOGANËS

‘Kam vendosur të importoj disa mallra importi në BE. Çfarë dokumentash importi duhet të përdor?’

Për një përgjigje kësaj pyetje, shiko faqet në rrjet të paraqitura më poshtë.

Burim informacioni 1: Tryeza e punës Export Helpdesk për vendet në zhvillim (Kërkesat dhe Taksat)

Faqja e internetit: <http://exporthelp.europa.eu/>



Për të gjetur informacion në tryezën e punës të eksportit Export Helpdesk për vendet në zhvillim ndiq hapat.

Shembull: Çfarë dokumentash kërkohen për sheqerkat dhe karamelet e prodhuara në Serbi?

Hapi 1: lidhu me tryezën e punës (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: shko tek Formulari i Futjes së Kërkesave dhe Taksave *Requirements and Taxes Input Form* duke klikuar tek “Kërkesat dhe Taksat” ‘[Requirements and Taxes](#)’

Hapi 3: Në këtë Formular të dhënash plotëso tri fushat

1. kodin e produktit (p.sh. ‘17049075’ që gjendet nëpërmjet ‘broëse’ (kullot) ose nëpërmjet “kërko”)
2. vendin e origjinës (p.sh. ‘Serbia’ që zgjidhet nga menuja tërhiq poshtë, drop doën menu)
3. vendi i destinacionit (p.sh. Luksemburgu zgjidhet nga menuja drop doën)

Hapi 4: kliko ‘shfaq’ për të parë Listën e Kërkesës

Hapi 5: kliko në fund të çdo linje kërkesë për të më mësuar më shumë rreth saj

Shembull: Ky product duke qenë se është ushqimor, ka nevojë për Etiketimi për ushqimet *Labelling for foodstuffs*. Në këtë linjë kliko tek ‘EU/LU’ për të hapur një dritare të re që liston kërkesat përkatëse të etiketimit.

Hapi opsional: lexo tryezën e punës të detajuar Guida e Përdoruesit [User Guide](#) (klik), seksioni ‘rërkesat dhe taksat’.

Burim Informacioni 2: Tryeza e punës për eksportin Export Helpdesk për vendet në zhvillim (Marrëveshjet Preferenciale)

Faqja e internetit: <http://exporthelp.europa.eu/>



‘Dua të di më shumë rreth regjimeve të ndryshme tregtare në dispozicion për vendet në zhvillim. Cilat janë dokumentat që këto regjime kërkojnë për trajtimin preferencial të detyrimeve doganore?’

Hapi 1: futu në tryezën e punës për eksportin Export helpdesk (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: kliko mbi ”[Marrëveshjet preferenciale](#)”

Hapi 3: gjeni për cilat nga regjimet preferenciale një vend jo i BE-së kualifikohet:

Mundësia 1: për GSP, kliko mbi “[Sistemi i përgjithësuar i preferencave \(GSP\)](#)”

Mundësia 2: për vendet e ACP, kliko mbi “[Regjimi i taksave doganore preferenciale për shtetet afrikane, Karaibeve dhe Shtetet e Paqësorit \(ACP\)](#)”

Mundësia 3: për FTA, kliko mbi “[Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë](#)” dhe gjej një listë të vendeve përkatëse

Kjo listë përfshin: Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbinë

Mundësia 4: për ATP, kliko mbi “[Preferencat e Tregut Autonom](#)” (aktualisht mbulon vetëm Kosovën dhe Moldavinë)

Hapi 4: gjeni kërkesat mbi dokumentat sipas regjimit tuaj preferencial:

Kliko mbi “[Dokumentat që ju duhen për tu kualifikuar për marrëveshjet preferenciale](#)”.

Shih shembullin në faqen tjetër.

Shembull

Marrëveshjet Preferenciale

Kërkesat e dokumentave sipas Marrëveshjes së Asociimit dhe Stabilizimit ndërmjet Komunitetit Europian, nga njëra anë dhe Malit të Zi, nga ana tjetër

Sipas [Protokollit 3](#) të Marrëveshjes në lidhje me Përkufizimin dhe Konceptin e “Produkteve të origjinës” dhe metodës së bashkëpunimit administrativ, produktet që e kanë origjinën në Mal të Zi do të përfitojnë nga normat e taksave doganore preferenciale të parashikuara me paraqitjen ose të një certificate të lëvizjes EUR.1 ose të një deklarimi të faturës

Kliko linkun e mëposhtëm për të parë një model të dokumentave.

1. [Çertifikata e lëvizjes EUR.1](#)

Një çertifikatë lëvizje EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të vendit të eksportimit. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e këtij dokumenti do të përgatitet të paraqesë, me kërkesë të autoriteteve doganore të vendit eksportues, të gjitha dokumentat e nevojshme që provojnë statusin e origjinës së produkteve në fjalë.

2. [Deklarimi nga Eksportuesi](#)

Një deklarim i ngarkesës së mallrave të faturuara mund të bëhet:

- a) nga çdo eksportues për çdo dërgesë që përbëhet nga një apo më shumë pako që përmbajnë një vlerë totale të produkteve të origjinës e cila nuk i kalon € 6 000, ose
- b) nga një eksportues i miratuar i autorizuar në mënyrë të posaçme nga autoritetet doganore të vendit eksportues pavarësisht nga vlera e produkteve në fjalë.

Eksportuesi i miratuar

Një eksportues i miratuar është një eksportues i cili plotëson disa kushte të vendosura në nenin 23 të Protokollit 3 dhe të detyrueshme për autoritetet doganore dhe i cili lejohet të bëjë deklarime për faturat. Ashtu si autoritetet doganore mund të garantojnë atë status, ato gjithashtu mund ta tërheqin atë nëse eksportuesi keqpërdor apo abuzon me autorizimin. Procedurat bashkëngjitur me dhënien e statusit “eksportues i miratuar” varen nga parashikimet ligjore kombëtare.

Eksportuesi që mbush një deklarim faturimi do të përgatitet për të paraqitur, me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues, të gjitha dokumentat e nevojshme që provojnë statusin e origjinës së produkteve në fjalë.

Një deklarim i faturës do të nxirret nga eksportuesi duke e shtypur, stampuar apo printuar mbi faturën, shënimin e dorëzimit ose një dokument tjetër tregtar, deklarimin, tekstin që shfaqet në Shtojcën IV të Protokollit 3 duke përdorur një nga versionet linguistikë të caktuar në atë Shtojcë dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të brendshëm të vendit eksportues.

Deklarimet e faturës do të mbajnë firmën origjinale të eksportuesit në dorëshkrim. Megjithatë, një eksportues i miratuar mund të çlirohet nga ky rregull, duke siguruar që ai i jep autoriteteve doganore të vendit eksportues një marrje përsipër me shkrim nëpërmjet së cilës ai pranon përgjegjësi të plotë për çdo deklarim që e identifikon atë.

3. [Periudha e vlefshmërisë së provës së origjinës](#)

Periudha e vlefshmërisë është katër muaj.

Çlirimet nga kërkesa për të paraqitur dokumentin e origjinës

Paraqitja e një dokumenti origjine nuk kërkohet kur vlera totale e produkteve të importuara nuk i kalon € 500 në rastin e pakove të vogla ose € 1 200 në rastin e produkteve që bëjnë pjesë në bagazhin personal të udhëtarëve.

2.3. KUOTAT TARIFORE TË IMPORTIT

‘Mallrat e importuara në BE nganjëherë mund të përfitojnë nga një tarifë importi më e ulët por ky avantazh kufizohet në një sasi të caktuar të një produkti. Si gjendet informacion rreth këtyre kuotave tarifore?

Për një përgjigje të kësaj pyetjeje, shih faqen e mëposhtme të internetit.

Burim informacioni : KUOTAT E TARIFAVE AUTONOME – baza e të dhënave e Komisionit Europian

Adresa në rrjet: http://ec.europa.eu/taxation_customs/dds/qothome_en.htm

Hyrje

Kuotat tarifore

Kuotat tarifore të miratuara mbi bazën e Nenit 26 të Traktatit të Komunitetit Europian EC përbëjnë një përjashtim nga gjendja normale e punëve përderisa ato lejojnë, gjatë periudhës së vlefshmërisë së masës dhe për një sasi të kufizuar, dokumentin e heqjes dorë (pezullim total) apo të pjesshme (pezullim të pjesshëm) të taksave doganore normale të aplikueshme në mallrat e importuara (taksat doganore anti-damping nuk preken nga këto pezullime).

Preferenciale

Në kuadër të disa marrëveshjeve që Komuniteti Europian ka përmbyllur me vendet e treat, si dhe në kuadrin e marrëveshjeve preferenciale autonome për disa vende përfituese, parashikohen konçensione tarifore për një volum të para-caktuar mallrash. Këto konçensione tarifore quhen “kuota tarifore preferenciale”.

Brenda këtyre kuotave tarifore preferenciale, një vëllim i paracaktuar i mallrave që e kanë origjinën nga një vend i caktuar mund të përfitojnë në importimin në Komunitet nga një normë më e favorshme sesa taksa normale e vendeve të treat të përmendura në nomenklaturën e kombinuar. E drejta për të përfituar nga kuotat tarifore preferenciale është natyrisht subjekt në prezantimin e provave të nevojshme të origjinës.

Autonome

Siç thuhet tashmë për pezullimet, për disa sektorë ekonomikë, është e nevojshme të stimulohet konkurrenca me tarifa të ulëta, siç i gjejmë në sektorët e shumtë industrialë.

Roli i tyre është të stimulohet aktiviteti ekonomik i industrive të Komunitetit, duke përmirësuar kapacitetin konkurrues, strukturat modernizuese etj.

Ato normalisht u garantohen lëndëve të para, produkteve gjysëm të gatshme ose komponentëve jo në dispozicion në BE (pezullimet) ose të cilat janë në dispozicion por në sasi të pamjaftueshme (kuotat tarifore), por nuk janë garantuar kuota tarifore për produkte të përfunduara.

Një kërkesë për të hapur një kuotë tarifore autonome mund të paraqitet si e tillë ose të rezultojë nga ekzaminimi i një kërkesë pezullimi. Në këtë kuptim, llogaria do të merret, aty ku është e

nevojshme, për dëmtimin e shkaktuar ndaj çdo prodhimi të ri dhe të çdo kapaciteti prodhues, i cili do të ishte në dispozicion në Komunitet apo në një vend të tretë me marrëveshjet tarifore preferenciale.

Kur produktet identike, ekuivalente apo zëvendësuese janë prodhuar në sasi të mjaftueshme brenda BE ose nga prodhuesit në një vend të tretë me marrëveshjet tarifore preferenciale, garantimi i një kuotë normalisht përjashtohet. E njëjta gjë aplikohet aty ku masa mund të rezultojë në një shtrembërim të konkurrencës përsra i takon produkteve përfundimtare. Rregullorja e Këshillit 2505/96 (kuotat tarifore) cakton listën e mallrave subjekt i këtyre masave. Ajo amendohet rregullisht (në Janar dhe Korrik të çdo viti) për të marrë në shqyrtim kërkesa të reja të paraqitura ng Shtetet Anëtare.

Më shumë informacion dhe formularë mund të gjenden në Komunikimin e Komisionit në lidhje me pezullimet dhe kuotat autonome tarifore (Gazeta Zyrtare C 128 e datës 25/04/1998, p. 2) dhe në Rregulloren e Këshillit 2505/96 dhe amendamentin e saj të fundit (Gazeta Zyrtare L 003 of 07/01/2010, p. 1).

Menaxhimi

Shumica e kuotave tarifore menaxhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit përgjegjëse për Bashkimin Doganor mbi bazën e një slogani “ai që vjen i pari-atij i shërbehet” pavarësisht nga ku importohen mallrat për në BE. Dispozitat ligjore që udhëheqin menaxhimin e këtyre kuotave tarifore janë në Nenet 308a deri 308c të Rregullores (EEC) Nr 2454/93  që i shtrin dispozitat për zbatimin e Kodit Doganor të Komunitetit.

Informacion rreth bilanceve aktuale të atyre kuotave tarifore të cilat menaxhohen mbi bazën e i parit që vjen atij i shërbehet është në dispozicion on-line.

Bujqësore

Disa kuota tarifore menaxhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit përgjegjëse për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural nëpërmjet një sistemi të liçensave të importit. Rregullore të ndryshme të Këshillit dhe Komisionit përmbajnë dispozita të posaçme për menaxhimin e këtyre kuotave tarifore.

Baza e të dhënave

Për informacionin e përditësuar mbi kuotat tarifore dhe kuotat tavan në fuqi, Komisioni zhvilloi një bazë të dhënash. Ju mund të gjeni në të gjendjen aktuale të:

- Kuotave tarifore të Komunitetit, të menaxhuara mbi bazën e sloganit të parit që vjen atij i shërbehet

- Kufijtë tariforë të Komunitetit, në lidhje me importet nga origjina të caktuara

Çdo kuotë tarifore apo kufi tarifor identifikohet nga një numër rendor me gjashtë numra

Për të gjetur informacion në KUOTAT TARIFORE – baza e të dhënave ndjek hapat vijuese.

Example: import of sardines in olive oil from Albania.

Kërko kuotat tarifore në fuqi nëpërmjet një prej dy mënyrave të mëposhtëme:

Në ju dini Numrin Rendor, ju mund ta gjeni këtë informacion direkt në [AUTONOMOUS TARIFF QUOTAS - database](#)

Nëse ju nuk e dini Numrin Rendor, kërkoni fillimisht nr. e kodit doganor në [TARIC - database](#)

Mundësia 1: hap bazën e të dhënave të kuotave tarifore – nëpërmjet faqes së internetit ‘[Tariff quota consultation](#)’

- zgjidh vendin e origjinës (p.sh. Shqipëria) nga menuja drop-doën
- plotëso kutinë e numrit rendor (p.sh. tipi ‘091504’)
- kliko mbi ‘kërko’ dhe konsultohu me hollësitë e kuotave tarifore për këtë rast specifik

Mundësia 2: hap bazën e të dhënave tarifore ([TARIC](#))

- kërko nr. e kodit doganor nëpërmjet funksioneve ‘kullot’ ose ‘kërkim i avancuar’ dhe më pas gjej kodin e produktit 1604131100
- zgjidh vendin e origjinës (p.sh. Shqipëria) nga menuja drop-doën
- kliko mbi ‘Nxirr masat’
- kliko mbi numrin Rendor 091504
- konsultohu në këtë faqe me informacionin rreth bilancit aktual të kuotës tarifore.

Për informacion më të hollësishëm mbi kuotat dhe kufijtë tarifore:

- kontakto shërbimin e kuotave tarifore të Komisionit (TAXUD-B-5) në Nr. e Faksit (32 2) 296 33 06
- kontakto autoritetet doganore të Shteteve Anëtare

Disa kuota tarifore të Komunitetit, në veçanti për disa produkte bujqësore, menaxhohen mbi një bazë tjetër të ndryshme nga i pari që vjen atij i shërbehet. Informacioni rreth situatës aktuale të këtyre kuotave tarifore mund të merret nga përgjegjësi i shërbimeve të Komisionit.

2.4. MASAT ANTI-DAMPING

‘Cilat janë masat anti-damping?’

‘Cilat masa anti-damping merr në konsideratë BE për fletët e aluminit nga Brazili?’

‘Sa të larta janë çmimet e këtyre masave anti-damping? Si llogariten ato?’

Për një përgjigje për pyetjet anti-damping, shih faqet e internetit të prezantuara më poshtë.

Burim informacioni 1: Komisioni European – Përmbledhjet e legjislacionit të BE
(përmbledhje e rregullave anti-damping)

Adresat në rrjet:

http://europa.eu/legislation_summaries/alphabetical_index/index_a_en.htm

Për të gjetur një përmbledhje të legjislacionit anti-damping, ndiq hapat.

Hapi 1: futu në bazën e të dhënave mbi Përmbledhjet e legjislacionit të BE (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: zgjidh ‘[masat anti-damping](#)’ nga Indeksi alfabetik

Hapi 3: këshillohu këtu me një plan të procedurave, të aplikuara nga DG Tregtia e Jashtëme, për të identifikuar rastet ku ajo do të aplikojë taksat doganore anti-damping

Për të strukturuar leximin tuaj, merrni një ide paraprake mbi përafrimin me BE të masave të mëposhtëme anti-damping. Masat e BE nuk do të aplikohen pa u testuar tri kushte kryesore të aplikimit.

Kushti 1: Damping duhet të vlerësohet (dhe)

Kushti 2: Duhet të provohet dëmtimi i industrisë së Komunitetit (dhe)

Kushti 3: Dëmtimi duhet të rezultojnë nga një praktikë e veçantë damping.

Prova 1: Një produkt bën damping kur çmimi i tij brenda vendit të eksportit është më i lartë sesa çmimi i tij i eksportit.

Prova 2: Dëmtimi matet me luhatjet (e papritura) në vëllim, aksionet e tregut, ...

Prova 3: Dëmtimi duhet të vlerësohet për produkte të ngjashme të industrisë së komunitetit. Faktorët e njohur të ndryshëm nga importet e dampuara të cilat në të njëjtën kohë po dëmtojnë industrinë e Komunitetit duhet gjithashtu të shqyrtohen.

Kuadri ligjor

Rregullore e Këshillit (EC) Nr 384/96 datë 22 Dhjetor 1995 mbi mbrojtjen kundër importeve të dampuara nga vendet jo anëtare të Komunitetit European [Gazeta Zyrtare L 56, 06.03.1996].

Të amenduara nga aktet e mëposhtëme:

Rregullore e Këshillit (EC) Nr 2331/96 datë 2 Dhjetor 1996 (Gazeta Zyrtare L 317, 06.12.1996);

Rregullore e Këshillit (EC) Nr 905/98 datë 27 Prill 1998 (Gazeta Zyrtare L 128, 30.04.1998);

Rregullore e Këshillit (EC) Nr 2238/2000 datë 9 Tetor 2000 (Gazeta Zyrtare L 257, 11.10.2000);

Rregullore e Këshillit (EC) Nr 1972/2002 datë 5 Nëntor 2002 (Gazeta Zyrtare L 305 datë 07.11.2002);

Rregullore e Këshillit (EC) Nr 461/2004 datë 8 Mars 2004 (Gazeta Zyrtare L 77 datë 13.03.2004).

Rregullore e Këshillit (EC) Nr 2117/2005 datë 21 Dhjetor 2005 (Gazeta Zyrtare L 340 datë 23.12.2005).

Burim informacioni 2: Komisioni European – DG Tregtia

Adresa në internet: <http://ec.europa.eu/trade/tackling-unfair-trade/trade-defence/>

Për të gjetur informacion të përgjithshëm rreth masave anti-damping, ndiq hapat.

Hapi 1: futu në faqen e internetit në “Ndalimi i Tregtisë së Padrejtë – Mbrojtje e Tregtisë” (Kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: kliko në ‘[Anti-Dumping](#)’ dhe gjej informacion rreth

- legjislacioni anti-dumping
- kushtet
- ankesat
- investigimet
- masat
- monitorimi
- rishikimet
- kompensimet

Për të gjetur informacion rreth masave anti-damping për produktet e veçanta, ndiq hapat.

Hapi 1: futu në faqen e internetit në ‘[Anti-Dumping](#)’

Hapi 2: kliko tek “Dokumentat dhe publikimet me këtë subjekt” ‘[Documents and publications on this subject](#)’ dhe pastaj mbi “Lista e masave anti-damping dhe anti-ndihmë” ‘http://ec.europa.eu/comm/trade/issues/respectrules/anti_dumping/stats.htmAnti-dumping and anti-subsidy measures list’

Hapi 3: zgjidh nga lista e produkteve të përshtatshme (p.sh. flete alumini nga Brazili) dhe kliko në hiperlinket në kollonat “Masat e përkohshme”, “Masat definitive” dhe “Përfundimi” për informacion të mëtejshëm.

2.5. RREGULLAT E ORIGINËS

‘Cilat vende kanë marrëveshje tregtare preferenciale me BE?’

‘Si mund një eksportues/importues të japë një dokument për vendin e origjinës me qëllim që të përfitojë një tarifë preferenciale importi kur mallrat importohen në BE?’

‘Ku mund të gjejë ai informacion rreth rregullave për pëcaktimin e vendit të origjinës?’

Për një përgjigje ndaj këtyre pyetjeve, shih faqet e mëposhtëme në internet.

Burim informacioni 1: Komisioni Europian – Bashkimi i taksimit dhe doganave – Rregullat e Origjinës

Adresa në rrjet:

http://ec.europa.eu/taxation_customs/customs/customs_duties/rules_origin/index_en.htm

Për mallrat e importuara në një nga vendet e BE (Belgjikë, Bullgari, Republika Çeke, Danimarkë, Gjermani, Estoni, Greqi, Spanjë, Francë, Irlandë, Itali, Qipro, Letoni, Lituani, Luksemburg, Hungari, Maltë, Hollandë, Austri, Poloni, Portugali, Slloveni, Sllovaki, Finlandë, Rumani, Suedi dhe Mbretëri e Bashkuar), vend i origjinës do të përcaktojë marrëveshjen (et) tregtare preferenciale që mund të aplikohet tek to.

Përveç marrëveshjeve tregtare bilateral me [të tjerët](#) këto marrëveshje u takojnë:

Vendeve të [Afrikës, Karaibeve dhe Paqësorit \(ACP\)](#), bashkimit doganor me [Andora](#), [Turqi](#) dhe [San Marino](#), [Zona Ekonomike Europiane \(EEA\)](#), [Sistemi i grumbullimit Pan-Euro-Mesdhetar](#), [Sistemi i Përgjithësuar i Preferencave](#), [Amerika Latine](#), [\(OCT\)](#), [Afrika e Jugut](#) dhe [Ballkani Perëndimor](#). Kliko mbi këto regjime për një sqarim të qartë.

Shembull

Ballkani Perëndimor

- Prezantim i përgjithshëm

- [Shqipëria, Bosnia dhe Herzegovina, Serbia dhe Mal i Zi](#)
- Kroacia
- [Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë](#)

Prezantim i përgjithshëm

Shqipëria, Bosnja dhe Herzegovina (BiH), Kroacia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (fYRoM) dhe Serbia dhe Mal i Zi (S&M) janë pesë vende që zakonisht iu referohen si “Vendet e Ballkanit Perëndimor”. Këto vende janë të gjitha pjesë e procesit të Stabilizim dhe Asociimit, i cili u ofron prespektivë anëtarësimi në Bashkimin Europian menjëherë sapo të plotësohen kushtet.

Aktualisht, ekzistojnë dy tipe të veçanta marrëveshjesh me vendet në Ballkanin Perëndimor, të cilat të gjitha përfitojnë nga masat e veçanta tregtare që u garantojnë atyre hyrje të lirë në tregun e Komunitetit për pothuajse të gjitha produktet, vetëm me disa përjashtime. Në rastin e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë e Malit të Zi, ky trajtim shumë i favorshëm rezulton nga aplikimi i rregulloreve që fusin masa të tregtisë autonome (ATMs). Përsa i takon Kroacisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ajo rrjedh nga zbatimi i Marrëveshjeve të Stabilizim Asociimit.

Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi

Kuadri ligjor

Masat e tregtisë autonome (ATMs) aktualisht të aplikuara në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi e Mal i Zi fillimisht u futën me anën e [Rregullores së Këshillit \(EC\) Nr. 2007/2000](#) datë 18.9.2000 (OJ L 240, 23.9.2000). Kjo u amendua për herë të fundit nga Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 607/2003 datë 2.4.2003 (OJ L86, 3.4.2003).

Rregullat e zbatueshme të origjinës përmbahen në Nenet 66 and 98 to 123, and in Annexes 14, 15, 21 and 22, of [Commission Reg. \(EC\) No. 2454/93](#) (CCIP), ndryshuar me Rregulloret (EC) Nr 1602/2000, Nr 444/2002 dhe No 881/2003. Rregullat e listës janë të përfshira në Shtojcën 15 CCIP, ndryshuar nga Rregullorja (KE) Nr 881/2003.

Dispozita të veçanta

SHENIM: Këto dispozita të veçanta përmbajnë informacion vetëm për rastet kur rregullat e marrëveshjes së veçantë ndryshojnë nga dispozitat e përbashkëta, ose kur këto dispozita të përbashkëta kanë nevojë të plotësohen. Për rrjedhojë kontrolloni gjithmonë dhe dispozitat e përbashkëta.

Grumbullimi

Grumbullimi bilateral aplikohet vetëm në një drejtim, p.sh. Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë ose S&M mund të përpunojë më tej produktet që e kanë origjinën në KE ashtu sikur ta kishin origjinën në vendin e tyre (Neni 98). E njëjta gjë nuk është e mundur për Komunitetin.

Veprimet minimale

Lista e veprimeve minimale përfshihet në Nenin 101, ndryshuar me Rregulloren (KE) Nr 881/2003.

Rregull i përgjithshëm i tolerancës

Niveli i tolerancës së përgjithshme për produktet jo tekstile caktohet në 10% (Neni 102).

Nuk ka rregulla tërheqjeje

Nuk ka ndalim të tërheqjes.

Vërtetimi i origjinës

Vërtetimi i statusit të origjinës mund të bëhet nga paraqitja ose e një certificate të origjinës EUR.1 ose një deklarate faturë (Neni 109).

Vërtetimi normal i origjinës është certifikata e lëvizjes së mallit EUR.1 (Nenet 110 deri 115). Deklarimi i faturës mund të bëhet nga çdo eksportues mallrash vlera totale e të cilave nuk i kalon € 6 000, por vetëm me një eksportues të miratuar të Komunitetit nëse kjo vlerë kalohet (Nenet 116 dhe 117).

Periudha e vlefshmërisë së çdo vërtetimi të origjinës është 4 muaj.

Eksportuesi i miratuar

Vetëm autoritetet doganore në Komunitet mund të garantojnë statusin e “eksportuesit të miratuar” (Neni 117). Kjo nuk është e mundur për Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën apo S&M.

Kroacia

Kuadri Ligjor

[Marrëveshja e Stabilizim Asocijimit](#) (SAA - OJ L 26, 28/1/2005, p. 3) ndërmjet BE dhe Kroacisë hyrë në fuqi më 1 Shkurt 2005. Një Marrëveshje e Përkohshme mbi çështjet e tregtisë dhe të lidhura me tregtinë u aplikuan nga 1 Janari 2002.

Rregullat e aplikueshme të origjinës përfshihen në [Protokollin 4 të MSA](#) (f. 124 në të njëjtën Gazetë Zyrtare), ndryshuar me [Protokollin i MSA](#) (OJ L 26, 28/1/2005, fq. 222) vendosur ndërmjet BE dhe Kroacisë për të marrë parasysh pranimin e 10 Shteteve të reja Anëtare të BE nga 1 Maj 2004. Rregullat e listës janë të përfshira në Shtojcën II të Protokollit 4.

Dispozita të veçanta

SHËNIM: Këto dispozita të veçanta përmbajnë informacion vetëm në rastet kur rregullat e marrëveshjes së veçantë ndryshojnë nga dispozitat e përbashkëta, ose kur këto dispozita të përbashkëta kanë nevojë të plotësohen. Për rrjedhojë, gjithmonë kontrollo edhe dispozitat e përbashkëta.

Grumbullimi

Grumbullimi bilateral aplikohet për materialet që e kanë origjinën në secilin nga vendet palë (Nenet 3 dhe 4).

Rregulli i tolerancës së përgjithshme

Niveli i tolerancës së përgjithshme për produktet jo tekstile është caktuar në 10% (Neni 6).

Veprimet minimale

Lista e veprimeve minimale është e përfshirë në Nenin 7.

Parimi i territorialitetit

Derogimi nga parimi i territorialitetit aplikohet në të gjitha produktet me përjashtim të tekstileve (Neni 12),

por kufizohet në 10% të totalit të vlerës së shtuar të kërkuar jashtë territoreve të palëve.

Nuk ka rregull të rikthimit të pagesës së doganës

Aplikohet një ndalesë e përgjithshme e rikthimit të pagesës së doganës. (Neni 15). Megjithatë, Kroacisë i lejohet të aplikojë një rikthim të pjesshëm të pagesës së doganës me taksa të sheshta (5% për produktet e Kapitujve 25 deri 49 të HS dhe 64 deri 97, dhe 10% për produktet HS Kapitujt 50 deri 63, p.sh. tekstilet) deri më 31/12/2005 .

Vërtetimi i origjinës

Produktet e prejardhura mund të përfitojnë nga trajtimi preferencial në importimin në Komunitet ose në Kroaci me paraqitjen ose të një certificate të lëvizjes EUR. 1 (Neni 17 deri 20). Deklarata e faturimit mund të bëhet nga një eksportues për mallrat vlera totale e të cilave nuk e kalon shumën prej € 6 000 ose nga një eksportues i miratuar nëse kjo vlerë është tejkaluar (Neni 21 dhe 22).

Periudha e vlefshmërisë së çdo vërtetimi origjine është 4 muaj (Neni 23).

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Kuadri Ligjor

[Marrëveshja e Stabilizim Asocijimit](#) (MSA - OJ L 84, 20/3/2004, fq. 13) ndërmjet Komunitetit Europian dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë hyrë në fuqi më 1 Prill 2004. Një Marrëveshje e Përkohshme mbi tregtinë dhe çështjet e lidhura me tregtinë u aplikua më 1 Prill 2001.

Rregullat e aplikueshme të origjinës janë të përfshira në [Protokollin 4 të MSA](#) (fq. 108 në të njëjtën Gazetë Zyrtare), ndryshuar nga [Protokolli i MSA](#) (Gazeta Zyrtare L 388, 29/12/2004, fq. 3) i lidhur ndërmjet BE dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë duke marrë parasysh pranimin e 10 Shteteve të reja anëtare të BE nga 1 Maj 2004. Rregullat e listës janë të përfshira në Shtojcën II të Protocol 4.

Dispozitat e veçanta

SHËNIM: Këto dispozita të veçanta përmbajnë informacion vetëm në rastet kur rregullat e marrëveshjes së veçantë ndryshojnë nga dispozitat e përbashkëta, ose kur këto dispozita të përbashkëta kanë nevojë të plotësohen. Për rrjedhojë, gjithmonë kontrolloni edhe [dispozitat e përbashkëta](#).

Grumbullimi

Grumbullimi bilateral aplikohet për materialet që e kanë origjinën në secilin prej palëve (Neni 3 dhe 4).

Rregulli i tolerancës së përgjithshme

Niveli i tolerancës së përgjithshme për produktet jo tekstile është caktuar në 10% (Neni 6).

Veprimet minimale

Lista e veprimeve minimale përfshihet në Nenin 7.

No drawback rule

Aplikohet një ndalesë e përgjithshme e rikthimit të pagesës së doganës. (Neni 15). Megjithatë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë i lejohet të aplikojë një rikthim të pjesshëm të pagesës së doganës me taksa të sheshta (5% për produktet e Kapitujve 25 deri 49 të HS dhe 64 deri 97, dhe 10% për produktet HS Kapitujt 50 deri 63, p.sh. tekstilet) deri më 31/12/2005 .

Proof of origin

Produktet e prejardhura mund të përfitojnë nga trajtimi preferencial në importimin në Komunitet ose në

Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë me paraqitjen ose të një certificate të lëvizjes EUR. 1 ose të një deklarimi të faturës (Neni 16).

Prova normale e origjinës është çertifikata e lëvizjes EUR.1 (Nenet 17 deri 20). Deklarimi i faturës mund të bëhet nga një eksportues për mallrat vlera totale e të cilave nuk kalon shumën prej € 6 000 ose nga një eksportues i miratuar nëse kjo vlerë tejkalohet (Nenet 21 dhe 22).

Periudha e vlefshmërisë së çdo vërtetimi të origjinës është 4 muaj (Neni 23).

Disa vende përfitojnë nga më shumë sesa një marrëveshje. Kjo do të thotë thjesht se mund të aplikohet marrëveshja më fitimprurëse.

Kjo faqe interneti mbi rregullat e origjinës ndahet në katër pjesë kryesore:

- [Hyrja](#)
- [Origjina jo-preferenciale](#)
- [Origjina preferenciale](#)
- [Bashkimet doganore](#) (me Turqi, Andorën dhe San Marinon)

Origjina Jo-Preferenciale

Hyrje

Rregullat Jo-Preferenciale përdoren për të gjitha llojet e masave të politikës tregtare, si për shembull, taksat doganore anti-damping dhe të kundërveprimit, embargot tregtare, masat e sigurisë dhe ndëshkruese, por gjithashtu për disa kuota tarifore, për statistikën tregtare, për tenderat publike, për shënimin e origjinës e kështu me radhë. Përveç kësaj, kthimet e shpenzimeve të eksportit me BE në kuadrin e Politikës së Përbashkët Bujqësore shpesh bazohen në origjinën jo-preferenciale.

Harmonizimi i ËTO

Anëtarët e ËTO kanë rënë dakord të harmonizojnë rregullat jo-preferenciale të origjinës. Për këtë qëllim Marrëveshja e Marrakesh-it mbi Rregullat e Origjinës (1994) ngriti një program pune (HËP).

Aspektet e përgjithshme të origjinës preferenciale

Hyrje

Origjina preferenciale i akordohet mallrave nga vende të veçanta, të cilat kanë plotësuar disa kritere që lejojnë të deklarohen normat preferenciale të taksave doganore.

Dispozitat e përgjithshme

Ndërkohë që dispozitat e marrëveshjeve individuale mund të ndryshojnë në disa elementë, shumica e marrëveshjeve preferenciale të origjinës kanë disa dispozita të përbashkëta.

Kuadri ligjor për origjinën preferenciale

Çdo marrëveshje individuale ka bazën e saj ligjore.

Rregullat e listës

Lista e punës apo përpunimit që kërkohet të kryhet mbi materialet jo-të prejardhura me qëllim që produkti i prodhuar të mund të fitojë statusin e prejardhur.

Lista e marrëveshjeve preferenciale

1) Sistemi i përgjithësuar i preferencave

Lehtësi e garantuar në mënyrë të njëanshme për vendet në zhvillim përfshi "Gjithçka përveç iniciativës së krahëve" për Vendet më Pak të Zhvilluara.

2) Zona Ekonomike Europiane

ZEE (KE, Islanda, Norvegjia dhe Litenshtejni) konsiderohet si një territor i vetëm me një status të përpashkët të prejardhur nga ZEE

3) Sistemi i grumbullimit Pan-Euro-Mesdhetar

Një sistem i grumbullimit Pan-Euro-Mes i origjinës është një zgjerim i sistemit të mëparshëm të grumbullimit Pan-European. Ai për rrjedhojë operon ndërmjet KE dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit European të Tregtisë së Lirë (Islanda, Litenshtejni, Norvegjia dhe Zvicra) dhe Turqia dhe vendet të cilat nënshkruan Deklaratën e Barcelonës, domethënë Algjeria, Egjipti, Izraeli, Jordania, Lebani, Maroku, Siria, Tunizia dhe Autoriteti i Palestinës së Bankës Botërore dhe Rripit të Gazës. Ishujt Faroe i janë shtuar gjithashtu sistemit.

4) Vendet e Ballkanit Perëndimor

Në sajë të mekanizmit ndërkombëtar procedural, sistemi i Madridit i ofron pronarit të një marke tregtare mundësinë për të pasur markën e tij tregtare të mbrojtur në disa vende thjesht duke rregjistruar një aplikim drejtpërdrejt me zyrën e tij kombëtare ose rajonale (anëtarët e Unionit të Madridit janë të disponueshëm në [PDF](#)). Një markë ndërkombëtare e rregjistruar si e tillë është ekuivalente me një aplikim apo një rregjistrim të të njëjtës markë me efekte direkte në secilin prej vendeve të përcaktuar nga aplikanti. Nëse zyra e markës tregtare e një vendi të caktuar nuk refuzon mbrojtjen brenda një periudhe të caktuar, mbrojtja e markës është e njëjtë sikur të ishte rregjistruar nga ajo Zyrë. Sistemi i Madridit thjeshton gjithashtu mjaft menaxhimin pasues të markës, meqënëse është e mundur të rregjistrohen ndryshimet pasuese apo të rinovohet rregjistrimi nëpërmjet një hapi të vetëm procedural. Vende të tjera mund të caktohen në vijim.

5.3. MBROJTJA E MODELEVE DHE DIZENJOVE NË BE

Burim informacioni: Zyra për Harmonizimin në Tregun e Brendshëm (OHIM)

Faqja e internetit: <http://oami.europa.eu/en/design/default.htm>



Dizenjo e rregjistruar e komunitetit:

- jep të drejtën ekskluzive për ta përdorur dizenjon në tregti dhe për të ngritur padi kundër shkelësve dhe për të kërkuar dëmshpërblimet,
- shërben si parandalues kundër shkeljes,
- është një e drejtë që fitohet shpejt me pak formalitete,
- është një e drejtë e vlefshme në gjithë tregun e BE,
- është një mbrojtje që ju lejon të ndaloni prodhimin e paautorizuar të dizenjos tuaj në të gjitha vendet e BE-së dhe ndalon importet në BE në të gjitha pikat e mundshme të hyrjes.



6. Gjetja e partnerëve të biznesit në Bashkimin European

6.1 Publikimin e propozimeve të tregtisë dhe bashkëpunimit në BE

6.2 Gjetja e partnerëve R&D në Europë

6.1. PUBLIKIMI I PROPOZIMEVE TË TREGTISË DHE BASHKËPUNIT NË BE

‘Cila bazë të dhënash / faqe interneti e drejtuar nga BE lejon një publikim të propozimeve të tregtisë dhe bashkëpunimit me qëllim që të gjejë partner potencialë biznesi në vende të ndryshme?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, shiko faqet e internetit të paraqitura më poshtë.

Burimi i informacionit 1: Komisioni Europian – DP Ndërmarrja dhe Industria
Rrjeti Europian i Ndërmarrjes

Faqja e internetit: http://ëëë.enterprise-europe-Netëork.ec.europa.eu/index_en.htm



Si ta përdorim këtë rrjet?

Një nga shërbimet që Rrjeti Europian i Ndërmarrjes ofron konsiston në ndihmën e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme për të gjetur partner biznesi të përshtatshëm duke përdorur bazën e të dhënave të bashkëpunimit të teknologjisë dhe biznesit të tij, duke dhënë informacion mbi mundësitë e ofruara dhe rrjetin ndërkombëtar.

Shoqëritë e interesuara mund të kontaktojnë një anëtar të rrjetit të EEN në rajonin e tyre nëpërmjet: http://ëëë.enterprise-europe-Netëork.ec.europa.eu/info/Netëork_en.htm

6.2. GJETJA E PARTNERËVE R&D NË EUROPE

‘Cilat baza të dhënash / faqe interneti të drejtuara nga BE lejojnë të kërkojnë për ndërmarrje Europiane, institute kërkimi, universitete etj. të cilët deshirojnë të bashkëpunojnë në fusha të ndryshme të -R&D, R&D të orientuara në treg me marrëveshje liçensimi dhe prodhimi, shoqëri bashkëpunimi, etj?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, shiko në faqen e internetit të prezantuar më poshtë.

Burim informacion 1: Kërkim i Komunitetit & Shërbim i Zhvillimit të Informacionit (CORDIS)

Faqja e internetit: <http://cordis.europa.eu/>



CORDIS, Kërkimi i Komunitetit dhe Zhvillimi i informacionit, është një informacion interaktiv që ju mban të përditësuar me të rejat më të fundit, progresin dhe iniciativat në risinë, kërkimin dhe zhvillimin Europian.

Si ta përdorim këtë faqe interneti për të gjetur partner?

Hapi 1: futuni në faqen e internetit SHËRBIMI I PARTNERËVE CORDIS

<http://cordis.europa.eu/partners-service/>

Hapi 2: zgjidh ‘[Kërko për Partnerë](#)’

Alternativa 1: zgjidh një partner për kërkime të financuara nga BE

Hapi 3: Në rast interesimi për gjetjen e një partneri për një bashkëpunim të financuar nga BE R&D, fut një fjalë kërkimi (p.sh. ‘energji e ripërtëritshme’) në kutinë e sipërme

Hapi 4: zgjidh ‘projekt propozim’ nëse ju dëshironi të kërkonit për organizatat me propozimet R&D në sferën tuaj të interesit të cilën ata do të donin të realizonin me fondet e BE-së në të ardhmen e afërt dhe në një bashkëpunim me partner të tjerë Europianë

dhe/ose

‘ekspertizë shoqërie’ nëse ju dëshironi të gjeni organizata të cilat demostrojnë në profiling e tyre një aftësi të caktuar në fusha të veçanta R&D, p.sh. në sajë të projekteve të realizuara më parë të financuara nga BE-ja

Hapi 5: zgjidh një program i cili duket se përshtatet me interesat tuaja (p.sh. ‘CIP, një program që mbështet projektet në fushat e konkurrencës dhe novacionit).

Hapi 6: kliko mbi ‘kërko’ dhe shfaq profilet e shoqërive të listuara, kërko institucionet, universitetet etj.

Më shumë informacion mbi programet R&D të financuara nga BE-ja është i disponueshëm në adresën

http://cordis.europa.eu/fp7/home_en.html

Alternativa 2: zgjidh një partner për një bashkëpunim privat

Hapi 3bis: zgjidh një ose më shumë tipe bashkëpunimi

- mbështetje e mëtejshme R&D
- marrëveshje sipërmarrjeje të përbashkët
- marrëveshje liçense
- marrëveshje prodhimi
- marrëveshje marketingu

Hapi 4bis: zgjidh një ose më shumë rrjete mbështetjeje për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në rast se ju preferoni profilet e partnerëve potencialë të cilët janë prezantuar nga organizata ndërmjetëse profesionale si Pika Kombëtare Kontakti, Qendra Transferimi të Novacionit (IRCs) ose Qendra Europiane Informacioni (EICs).

Hapi 5bis: zgjidh një ose më shumë vende interesi ku ju do të donit të gjenit partnerë të fuqishëm

Hapi 6bis: kliko mbi ‘kërko’ dhe shfaq profilet e shoqërive të listuara, kërko institutet, universitetet, etj.

Burim informacioni 2: EUREKA (Rrjeti për Tregtinë e Orientuar R&D)
--

Faqja e internetit: <http://ëëë.eureka.be/home.do>



Raising the productivity and competitiveness of European businesses through technology. Boosting national economies on the international market, and strengthening the basis for sustainable prosperity and employment.

EUREKA është një rrjet pan-Europian për R&D industriale të orientuara në treg.

Themeluar në 1985, për të sfiduar migrimin gjithnjë e në rritje të R&D dhe novacionet industrial në vendet Aziatike dhe Amerikano-Veriore, EUREKA sot bashkon 38 vende anëtare. Së bashku, ato ndihmojnë kërkimin dhe novacionin ndërkombëtar, të orientuar në treg nëpërmjet mbështetjes që ata ofrojnë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, industrinë e madhe, universitetet dhe institutet e kërkimit. Nëpërmjet EUREKA, këto organizata po prezantojnë produkte, metoda, dhe shërbime të reja, që ndihmojnë për ta bërë Europën ekonomikisht të fortë dhe shoqërisht të shëndetshme.

Rezultatet që rrjedhin nga projektet EUREKA janë kudo: teknologjia e telefonit celular gsm; sistemet e navigimit; kartat smart që mbështesin tregtinë elektronike dhe me celular; programet e efekteve të veçanta filmike për kinemanë; pajisjet mjekësore; pajisjet dhe teknologjitë mjekësore më të mira për të monitoruar dhe kufizuar ndotjen mjedisore.

[Grupimet EUREKA](#) janë partneritete afat gjata publik-privat, strategjikisht të rëndësishme.

Pjesa më e madhe e shoqërive kryesore të Europës marrin pjesë në grupimet EUREKA, duke zhvilluar teknologji me rëndësi kyçe për konkurrencën Europiane. [Çadrat EUREKA](#) janë rrjete tematike që fokusohen në një sektor biznesi apo teknologjie të veçantë. Qëllimi i tyre është të gjenerojnë dhe mbështesin projektet R&D në fushën e tyre specifike të veprimit.



[Programi i EUREKA Eurostars](#) është programi i parë mbështetës dhe financues Europian që i kushtohet në mënyrë të veçantë Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme të kërkim-veprimit. Eurostars i stimulon ato të drejtojnë projekte ndërkombëtare të kërkimit dhe novacionit bashkëpunues. Qëllimi i Eurostars është “Të mbështesë sipërmarrësit ekzekutues R&D nëpërmjet financimit të aktiviteteve të tyre kërkimore, duke i bërë ata të aftë të konkurojnë në nivel ndërkombëtar dhe të bëhen lider në sektorin e tyre.”

Si ta përdorim këtë faqe interneti?

I. FILLIMI I NJË PROJEKTI

I.1. Gjetja e partnerëve

Hapi 1: futu në faqen e internetit [EUREKA](#)

Hapi 2: zgjidh ‘Projektet dhe më pas ‘Bëhu pjesëmarrës

Hapi 3: zgjidh 'Si të fillojmë një projekt', 'Propozo një ide project' ose 'Shkarko formularin e aplikimit të projektit'

I.2. Gjetja e financimit

Hapi 1: futu në faqen e internetit [EUREKA](#)

Hapi 2: zgjidh 'Aktivitetet' dhe më pas 'Eurostars'

Hapi 3: konsultohu [këtu](#) me informacion rreth 'Rregjistrimi', 'Udhëzuesit për aplikantët', 'Plotëso një aplikim', etj.

II. KËRKIMI I PROJEKTEVE EUREKA

Hapi 1: futu në faqen e internetit [EUREKA](#)

Hapi 2: zgjidh 'Projektet' dhe më pas 'Kërko Projekt'

Hapi 3: zgjidh 'Projekte në kërkim të partnerëve', 'Projekte të përfunduara', 'Zhvillimi i projekteve', ose 'Projektet Eurostars'

Hapi 4: fut një fjalë kyçe në kutinë e kërkimit (p.sh. 'komunikimi satelitor')

Hapi 5: konsultohu me një përmbledhje ose plan projekt ose informacion rreth pjesëmarrësve

7. Fillimi i një biznesi në Bashkimin European

- 7.1. Kërkesat ligjore dhe stimujt për krijimin e një shoqërie në Bashkimin European
- 7.2. Sisteme të sigurimit shoqëror në BE
- 7.3. Sistemi i Taksimit në Shtetet Anëtare të BE

7.1. LEGAL REQUIREMENTS AND INCENTIVES FOR CREATING A COMPANY IN THE EU

‘Èhere can I find information about legal forms, required licences, taxes, labour laës, etc. for starting and running a company in another European country?’

‘Èhere can I find information about national or regional financial and fiscal incentives for starting or expanding a company in other European countries?’

For an ansëer to these questions, look into the Faqja e internetits presented beloë.

Information source 1: European Commission Your Europe - Business

Faqja e internetit: http://ec.europa.eu/youreurope/business/index_en.htm

Hoë to use this Faqja e internetit?

Step 1: login to the [Your Europe – Business Faqja e internetit](#)

Step 2: click on ‘Starting-up’ and then on ‘Start-ups’

Step 3: click on the flag of the country of your choice

Step 4: consult here info on legal requirements, administrative procedures, etc.

Information source 2: European Commission – DG Enterprise and Industry
Enterprise Europe Netëork (EEN)

Faqja e internetit: http://ëëë.enterprise-europe-Netëork.ec.europa.eu/index_en.htm

Country guides and references to useful Faqja e internetits are also available at the members of the Enterprise Europe Netëork (EEN). These documents and ëeb pages usually contain a brief presentation about folloëing topics:

- economic indicators
- formalities for starting a business
- inëard investment incentives
- labour laë
- social security
- direct and indirect taxes
- agreements on prevention of double taxation
- useful contacts

7.2. SISTEMET E SIGURIMIT SHOQËROR NË BASHKIMIN EUROPIAN

‘Shoqëria jonë dëshiron të punësojë dikë në një tjetër Shtet Anëtar të BE me qëllim që të përfaqësojë shoqërinë tonë atje. Cilat janë taksat e punëdhënësve dhe punëmarrësve që ne duhet të paguajmë?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, shiko në faqen e mëposhtme të internetit.

Burimi i informacionit: Komisioni European – DP Shanset e Barabarta të Punësimit dhe Çështjeve Sociale
MISSOC – Sistemi i Përbashkët i Informacionit mbi Mbrojtjen Sociale në Mbrojtjen Sociale në Shtetet Anëtare të BE de EEA
Faqja e internetit: <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=815&langId=en>

MISSOC nxjerr rregullisht tabela krahasuese që mbulojnë të gjitha fushat e mbrojtjes sociale dhe Buletinë Informacioni të MISSOC me tema të veçanta dhe mbi ndryshimet kryesore në sistemet e mbrojtjes sociale

Si ta përdorim këtë faqe interneti?

Hapi 1: futu në bazën e të dhënave [MISSOC](#)

Hapi 2: përgatit një kriter duke zgjedhur vendet përkatëse dhe llojin e kontributeve të sigurimit shoqëror për të cilin ju jeni të interesuar

Hapi 3: kliko mbi ‘kërko’ dhe konsultohu me informacionin në ekran

Shoqëritë që kanë nevojë për informacion më të hollësishëm rreth detyrimeve të sigurimit shoqëror mund të konsultohen me një anëtar të [Rrjetit European të Sipërmarrjeve](#) pranë vendit ku ata dëshirojnë të fillojnë një aktivitet biznesi.



7.3. SISTEMI I TAKSIMIT NË SHTETET ANËTARE TË BE

‘Ku mund të gjej një vështrim të përgjithshëm mbi taksat e përbashkëta në Shtetet Anëtare të BE?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, shikoni faqen e mëposhtme të internetit.

Burimi i informacionit: Komisioni Europian – DP Bashkimi i Doganave dhe i Taksave

Faqja e internetit:

http://ec.europa.eu/taxation_customs/taxation/gen_info/info_docs/tax_inventory/index_en.htm

Baza e të dhënave ‘Taksat në Europë’ është një mjet informacioni në rrjet që mbulon taksat kryesore në fuqi në Shtetet Anëtare të BE.

Baza e të dhënave "Taksat në Europë" përmban, për çdo taksë individuale, informacion mbi bazën e saj ligjore, bazën e vlerësimit, shembujt kryesorë, normën (at) e aplikueshme, klasifikimin ekonomik dhe statistikor, si dhe të ardhurat që rrjedhin prej saj.

Baza e të dhënave ‘Taksat në Europë’ mbulon llojet e mëposhtme të taksave:

- të gjitha taksat kryesore në lidhje me të ardhurat (taksat personale, taskat e përbashkëta të të ardhurave, taksat e vlerës së shtuar, taksa e akcizës);
- taksat kryesore të sigurimit shoqëror;
- lista e taksave më të vogla që tregon më pak sesa 0.1 % të PBB.

8. Informacion mbi tregun

8.1. Informacion statistikor rreth tregtisë së jashtëme të BE

8.2. Panairet tregtare në BE (dhe në mbarë botën)

8.1. INFORMACION STATISTIKOR RRETH TREGTISË SË JASHTËME TË BE

‘Ku gjendet informacioni statistikor për importimin dhe eksportimin e mallrave në Bashkimin European?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, shiko në faqet e mëposhtëme të internetit.

Burim informacioni 1: Komisioni Europian – DP Tryeza e ndihmës Eksporteve - Tregtare për vendet në zhvillim Trade

Faqja e internetit:

<http://exporthelp.europa.eu/thdapp/comext/ComextServlet?languageId=EN>



**EXPORT
HELPDESK**
for developing countries

Seksioni ‘Statistikat Tregtare’ në Tryezën e Ndhmës së eksportit ofron të dhëna tregtare (të eksporteve dhe importeve) për BE dhe Shtetet e saj Anëtare.

Si të gjejmë statistikat?

Hapi 1: Fut një kodin e një produkti (p.sh. ‘7402’) ose kërkoni një kod të caktuar

Hapi 2: Zgjidh një vend raportues (p.sh. ‘EUR 27’ = të gjitha shtetet e BE)

Hapi 3: Zgjidh një vend partner (p.sh. ‘Të gjithë partnerët’)

Hapi 4: Zgjidh një vit (p.sh. ‘2010’)

Hapi 5: Zgjidh treguesit, p.sh.

- Vlera e importit
- Sasia e importit
- Vlera e eksportit
- Sasia e eksportit

Hapi 6: Kliko mbi “Shfaq” dhe konsultohu me tabelën

Burim informacioni 2: Zyra Statistikore - Eurostat – e Komuniteteve Europiane

Faqja e internetit: <http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/statistics/themes>

Eurostat ofron statistika mbi çështje të ndryshme si:

- Statistika të përgjithshme dhe rajonale
- Ekonomi dhe financë
- Popullsia dhe kushtet sociale
- Industria, tregtia dhe shërbimet
- Bujqësia dhe peshkimet
- Tregtia e Jashtëme
- Transporti
- Mjedisi dhe energjia
- Shkenca dhe teknologjia

Si ta përdorim këtë faqe interneti?

Zgjidh një subjekt nëpërmjet ‘Statistikat sipas temës’, listës alfabetike ‘Statistikat A-Z’ ose konsultohu me ‘shlfeto / kërkohet bazën e të dhënave’.

8.2. PANAIRET TREGTARE NË EUROPEË (DHE NË MBARË BOTËN)

‘Ku mund të gjejme informacion rreth panaireve ndërkombëtare të cilat do të zhvillohen në vende të tjera apo jashtë Europës?’

Për t’ju përgjigjur këtyre pyetjeve, shiko në faqet e mëposhtëme të internetit.

Burim informacioni: Baza e të dhënave Expo M+A

Faqja e internetit: <http://ëëë.expodatabase.com/>



Për të gjetur informacion në Bazën e të Dhënave Expo M+A, ndiq shembullin.

Shembull: Kur do të zhvillohet panairi tjetër i ushqimit në Köln, Gjermani?

Hapi 1: futu në faqen kryesore të internetit të Bazës së të dhënave M+A Expo (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: fut një fjalë, p.sh. ‘ushqimi në Gjermani’ në kutinë e kërkimit

Hapi 3: zgjidh një kuadër kohor (‘nga data’ + ‘deri në datën’) brenda së cilës panairi tregtar duhet të zhvillohet

Hapi 4: kliko mbi ‘vazhdo’

Hapi 5: shfaq listën me rezultate dhe gjej datën e edicionit tjetër të panairit tregtar të Anuga (shih më poshtë)

08Tetor-12Tetor2011

Kolonjë, Gjermani

Anuga-Panairi Tregtar kryesor për Industrinë Botërore të Ushqimit

9. Aspektet ligjore (kontraktuale) të bërjes biznes me BE

- 9.1. Kontratat me ndërmarrjet e BE
- 9.2. Incoterms
- 9.3. Kreditet e dokumentave
- 9.4. Faturimi elektronik

9.1. ASPEKTET LIGJORE (KONTRAKTUALE)– KONTRATAT ME NDËRMARRJET E BE-së

‘Ku mund të gjejë një shoqëri një kontratë model për një marrëveshje distribucioni ose agjencie ose për një transaksion shitjesh ndërkombëtar?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, konsultohuni me faqet e internetit të paraqitur më poshtë.

Burim informacioni 1: ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë

Faqja e internetit: <http://www.iccbo.org>



Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë boton (ICC) kontratat model dhe udhëzuesit përsa i përket marrëveshjeve dhe kontratave në marrëdhëniet dhe transaksionet ndërkombëtare të biznesit.

Për të **gjetur informacion** rreth publikimeve në dispozicion ndiqni hapat e mëposhtëm.

Hapi 1: futu në faqen e internetit (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: kliko në ‘[Librari](#)’

Hapi 3: zgjidh “Biznesi Ndërkombëtar & Kushtet Tregtare” dhe ‘Modeli i Kontratave Tregtare’

Hapi 4: shfaq listën me publikimet e mëposhtëme.

- ICC Modeli i Liçensës Ndërkombëtare të Markës Tregtare
- ICC Modeli i Kontratës Ndërkombëtare të Transferimit të Teknologjisë
- ICC Modeli i Kontratës së Sigurimit për Projektet e mëdha
- Hartimi dhe negocijimi i kontratave ndërkombëtare tregtare
- ICC Manuali Ligjor mbi Kontratat globale ne vendin e origjinës
- ICC Modeli i Kontratës Ndërkombëtare të Shitjes
- ICC Modeli i Kontratës Ndërmjetëse të Rastit
- ICC Modeli i Marrëveshjes së Konfidencialitetit

- ICC Modeli i Kontratës Tregtare të Agjencisë – edicioni i 2^{-të}
- ICC Modeli i Kontratës së Distribucionit
- ICC Kontratat në formular të shkurtër model
- ICC Modeli i Kontratës për Furnizim Sigurisë së një Impianti Industrial
- ICC Modeli i Kontratës Ndërkombëtare të Franshizës
- ICC Modeli i Kontratës Përzgjedhëse të Distribucionit
- ICC Modeli i Kontratës së Bashkimeve & Blerjeve 1– Kontratë Shitje Aksionesh
- ICC Klauzola e Forcës Madhore 2003 – ICC Klauzola e vështirësive 2003

Hapi 5: kliko mbi ‘Bli tani’ për të porositur këto publikime

Megjithëse këto kontrata model janë shumë të dobishme, shoqëritë rekomandohen fuqishëm të kërkojnë një konsulent ligjor të specializuar për të plotësuar kontratat sipas dëshirave të tyre.

Burim informacioni 2: Juris International (Qendra Ndërkombëtare Tregtare – UNCTAD / ËTO)

Faqja e internetit: <http://ëëë.jurisint.org/en/con/index.html>



Konsultohuni këtu me një listë të gjerë të kontratave model për temat e mëposhtëme:

- [Agjenci](#) (4)
- [Audiovizual](#) (13)
- [Buy Back - Countertrade transactions](#) (2)
- [Konfidencialiteti dhe marrëveshja e mos konkurimit](#) (13)
- [Ndërtimi, instalimi i implantit, projektimi](#) (3)
- [Transferimi i të dhënave](#) (1)
- [Distribucioni](#) (3)
- [Tregtia elektronike, Internet dhe multimedia](#) (28)
- [Franshiza](#) (2)
- [ITC kontratat model](#) (38)
- [Sipërmarrjet e përbashkëta, konsorcium dhe marrëveshjet e bashkëpunimit](#) (8)
- [Letër qëllimi / Memorandum mirëkuptimi](#) (8)
- [Liçensimi \(patenta, marka tregtare dhe njohuritë teknike\)](#) (24)
- [Makinieri \(furnizimi, etj.\)](#) (4)
- [Muzikë](#) (4)
- [Prokurimi](#) (12)
- [Botimi](#) (18)
- [Kërkimi](#) (6)
- [Shitja e mallrave të prodhuara dhe gjysëm të gatshme](#) (1)
- [Shitja e mallrave që prishen, artikujve të përdorimit të gjerë dhe lëndëve e para – Kakao](#) (4)
- [Shitja e mallrave që prishen, artikujt të përdorimit të gjerë dhe lëndëve e para – Të përgjithshme](#) (5)
- [Shitja e mallrave që prishen, artikujt të përdorimit të gjerë dhe lëndëve e para - Drithrat, farat vajore dhe furnizimi i ushqimeve](#) (35)
- [Shitja e mallrave që prishen, artikujt të përdorimit të gjerë dhe lëndëve e para – Të tjera](#) (1)
- [Shërbimet](#) (7)
- [Nënkontraktimi](#) (1)
- [Asistencë teknike](#) (2)

9.2. ASPEKTET LIGJORE (KONTRAKTUALE)- INCOTERMS

‘Ku mund të gjejë një shoqëri një prezantim dhe sqarim të termave ndërkombëtarë industrial të cilat përdoren në tregtinë ndërkombëtare?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, konsultohuni me faqet e internetit të paraqitura më poshtë.

Burimi i informacionit 1: ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë

Faqja e internetit: <http://ëëë.iccëbo.org>



Termet Ndërkombëtarë Tregtarë përkufizojnë përgjegjësitë e blerësit dhe shitësit për shpërndarjen e mallrave sipas kontratave të shitjes. *Incoterms 2010* është teksti i mirëinformuar për përcaktimin sesi shpërndahen mbi palët kostot dhe risqet. Këto terma përfshihen rregullisht në kontratat e shitjeve në mbarë botën dhe bëhen pjesë e gjuhës së përditshme të tregtisë.




Incoterms® 2010

by the International Chamber of Commerce (ICC)

Për të gjetur informacion rreth publikimeve në

dispozicion ndiqni hapat e mëposhtëme.



Hapi 1: futu në faqen e internetit (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: kliko mbi ‘[Librari](#)’

Hapi 3: zgjidh ‘Biznes Ndërkombëtar / Kushtet e tregtisë’ dhe

‘Incoterms’

Hapi 4: shfaq listën me publikimet e mëposhtëme
Incoterms 2010 – version i punimit

Incoterms 2010 Poster Incoterms 2000 (punimi ose versioni elektronik i librit) Incoterms 2000 Poster

ICC Udhëzues për Incoterms 2000 (punimi ose versioni elektronik i librit)

Incoterms 2000: Një Forum Ekspertësh

Hapi 5: kliko mbi ‘Bli tani’ për të porositur këto publikime

Botimi 2010 përfshin 11 terma në vend të 13 në botimin e mëparshëm.

Termet e mëposhtëm nga Incoterms 2000 janë fshirë nga lista: DAF, DES, DEQ dhe DDU.

Janë shtuar në listë dy terma të reja: DAT dhe DAP.

DAT zëvendëson Incoterms 2000 rregulloren DEQ.

DAP zëvendëson Incoterms 2000 rregulloret DAF, DES dhe DDU.

Ndërsa Incoterms 2000 kishte katër kategori, Incoterms® 2010 ka vetëm dy kategori.

Incoterms® 2010 i sistemon termat tregtarë ndërkombëtarë në dy kategori si vijon:

Rregulloret për çdo mënyrë transporti

EXË - Ex Ëorks -

FCA - Free Carrier – transportim pa pagesë

CPT - Carriage Paid To – Transportim paguar

CIP - Carriage and Insurance Paid – Transportim dhe Siguracion paguar

DAT - Delivered At Terminal – Dorëzuar në Terminal

DAP - Delivered At Place – dorëzuar në vend

DDP - Delivered Duty Paid – Taksë dorëzimi e paguar

Rregulla vetëm për Transportin e Brendshëm Lumor dhe Detar

FAS – Free Alongside Ship - Pa pagesë bashkë me anijen

FOB - Free On Board – Pa pagesë në anije

CFR - Cost and Freight – kosto dhe pagesë transporti

CIF - Cost, Insurance and Freight – Kosto – Siguracion dhe Taksë transporti

Përveç 11 rregullave, Incoterms® 2010 përfshin:

- Shënime të zgjeruara të udhëzuesit dhe grafikë ilustrues për të ndihmuar përdoruesit në mënyrë efikase të zgjedhin rregullin e drejtë për çdo transaksion;
- Klasifikimet e reja që ndihmojnë të zgjidhet rregulli më i përshtatshëm në lidhje me mënyrën e transportit;
- Këshillim për përdorimin e procedurave elektronike;
- Informacion mbi zhdoganimet në lidhje me sigurimin për ngarkesat;
- Këshillim për përdorimin e Incoterms® 2010 në tregtinë e brendshme.

I përdorur në kontratat ndërkombëtare dhe kombëtare për shitjen e mallrave, Incoterms ndihmon palët të shmangin keqkuptimet duke identifikuar qartë detyrimet e blerësit dhe shitësit.

Duke theksuar dy rregullat e reja, botimi Incoterms® 2010 përparon në tregtinë ndërkombëtare gjatë dekadës së fundit dhe është një mjet bazë për tregtinë. I përdorur si në kontratat ndërkombëtare ashtu dhe kombëtare për shitjen e mallrave, rregullat thjeshtojnë hartimin e këtyre kontratave dhe ndihmojnë të shmangen keqkuptimet duke përcaktuar qartë detyrimet e blerësve dhe shitësve.

Botimi i ri Incoterms® 2010 është në përdorim që nga 1 Janar 2011.

Burim informacioni 2: Trajnimi Ndërkombëtar i Biznesit

Faqja e internetit: <http://ëëë.i-b-t.net/incoterms.html#FOB>

Si ta përdorim këtë faqe interneti?

Konsultohuni këtu me një ‘Karta e Përgjegjësisë’ dhe/ose porosisni publikimin ‘Udhëzuesi IBT për Incoterms 2000’

9.3. ASPEKTET LIGJORE (KONTRAKTUALE) – KREDITË E DOKUMENTAVE

‘Ku mund të gjejë një shoqëri një përshkrim të të drejtave dhe detyrimeve të palëve të përfshira në kreditë e dokumentave?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, konsultohu me organizimin dhe faqen e internetit e cila paraqitet më poshtë.

Burim informacioni: ICC - Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë

Faqja e internetit: <http://www.iccbo.org>



Tani të përdorura universalisht, **Doganat uniform dhe praktika për kreditë e dokumentave (UCP)** janë rregullat private më të suksesshme për tregtinë që janë zhvilluar ndonjëherë.

Për të gjetur informacion rreth publikimeve në dispozicion ndiqni hapat e mëposhtëm.

Hapi 1: futu në faqen e internetit (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: kliko në ‘[Librari](#)’

Hapi 3: zgjidh ‘Sistemi bankar ndërkombëtar’

Hapi 4: shfaq listën me publikimet, të cilat përfshijnë:

- Manuali i përdoruesve për Kreditë e dokumentave sipas UCP 600 (2008)
- ICC Rregullat uniform për Rimbursimet nga Banka në Bankë sipas Kredive të Dokumentave (2008)
- Për të plotësuar UCP Doganat uniform dhe praktika për kreditë e dokumentave (2008)
- Njohuri në UCP 600 – Nenet e grumbulluara nga DCI 2003 deri 2008
- Komentar mbi UCP 600 (2007)
- ICC Doganat uniform dhe praktika për kreditë e dokumentave UCP 600 (2006)

Hapi 5: kliko mbi ‘Bli tani’ për të porositur këto publikime

9.4. ASPEKTET LIGJORE (KONTRAKTUALE) – FATURIMI ELEKTRONIK

‘Ku mund të gjej informacion rreth standarteve për faturimin elektronik në BE?

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, konsultohu me organizatën dhe faqen e internetit të paraqitur më poshtë.

Burim informacioni:	CEN
Faqja e internetit:	http://ëëë.e-invoice-gateëay.net/
 CEN/ISSS E-INVOICE GATEWAY http://ëëë.iccëbo.org/	

Qëllimi i platformës Porta e Faturimit Elektronik - **E-Invoicing-Gateëay** (EIG) është të identifikojë praktikat ligjore kombëtare më të përshtatshme në fushat përkatëse të biznesit elektronik, me qëllim që të kontribuojë në **thjeshtimin** dhe **përmirësimin** e kuadrit administrativ dhe rregullator për ndërmarrjet në biznesin elektronik në **fushën e faturimit elektronik**.

Në këtë platformë ju do të gjeni:

NJOHURITË BAZË:

- [‘Direktivën e Praktikës së mirë’](#) e cila ju mbështet në një fillim të thjeshtë të faturimit elektronik;
- [Informacion në lidhje me vendin rreth faturimit elektronik](#) i cili jep një vështrim të shpejtë rreth **përpjekjeve Europiane të faturimit elektronik**;
- Një [listë çështjesh](#) përsa i përket faturimit elektronik e cila tregon pikat kritike si dhe zgjidhjet e mundshme. Këtu ju jeni të ftuar të dërgoni një çështje për grupin e ekspertit (me formular poste në këtë paragraf):
- Teksti i **Direktivës së re të BE mbi faturimin elektronik**.
[Shko tek dokumentat](#)

ORGANIZATAT QË OPEROJNË NË FUSHËN E FATURIMIT ELEKTRONIK:

- Në seksionin [‘ORGANIZATAT’](#) ju do të gjeni shoqëritë dhe organizatat Europiane që operojnë në fushën e faturimit elektronike ([autoritetet e certifikimit](#), [autoritetet e standartizimit](#), [autoritetet e rregullimit](#), [iniciativat kombëtare](#), [portale informacionesh të përgjithshme](#), [autoritetet publike](#) dhe [ofruesit e zgjidhjeve](#)). Ata do t’ju ndihmojnë në fillimin e një faturimit elektronik.

10. Mundësitë e tregjeve publike ne Bashkimin European

10.1 Tenderat Europeanë dhe grantet

10.2. Prokurimi public në BE

10.1. MUNDËSITË E TREGJEVE PUBLIKE NË BE-TENDERAT DHE GRANTET EUROPIANE

‘Ku mund të gjejnë informacion shoqëritë rreth tenderave dhe granteve Europiane nëpërmjet të cilit institucionet Europiane financojnë zbatimin e punimeve, furnizimet e mallrave dhe shërbimet dhe realizimin e llojeve të ndryshme të organizatave?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, konsultohu me faqet e mëposhtme të internetit.

Burim informacioni 1: European Commission – EuropeAid Co-Operation Office of the European Commission

Faqja e internetit: <http://ec.europa.eu/comm/europeaid/index.htm>

Ëhat is EuropeAid?

EuropeAid – Ndihma Europiane Zhvillimi nëpërmjet multi - bashkëpunimit të palëve të interesuara

Bashkimi European, i përbërë nga Shtetet Anëtare dhe Komisioni European, është kontribuesi më i madh i ndihmës në botë. Zyra e Bashkëpunimit EuropeAid e Komisionit menaxhon programet e ndihmës së jashtme të BE dhe siguron që të jepet ndihmë për zhvillimin në mbarë botën.

Misioni kryesor i EuropeAid është të zbatojë instrumentet e ndihmës së jashtme të Komisionit, të dyja të financuara nga buxheti i Unionit dhe Fondi European i Zhvillimit. Seksioni ‘[Ëho's ëho](#)’ shpjegon si është e organizuar EuropeAid.

Për të siguruar lidhje logjike, plotësueshmëri dhe bashkërendim në zbatimin e programeve të jashtme të ndihmës, EuropeAid punon në bashkëpunim të ngushtë me [partnerë të ndryshëm të saj](#). Qëllimi i plotë është të bëjë ndihmën e jashtme më efektive. [Shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë e Shteteve Anëtare të BE](#) janë të gjithë aktorë të rëndësishëm në këtë fushë.

Njoftimet e mundësive të financimit

EuropeAid zbaton programet dhe projektet nëpër botë, sa herë që nevojitet ndihmë. Ajo shpërndan mbështetje nëpërmjet studimeve rajonale dhe specifike për vendet nëpërmjet një shumëllojshmërie sektorësh. Përveç kësaj, programet me një arritje globale lejojnë Komisionin European të ofrojë mbështetje të ngjashme për vendet që kanë pasur probleme, edhe nëse ata janë mijëra kilometra larg.

EuropeAid harton një seri mjetesh financiare të BE dhe programe për të bashkëpunuar me partnerë nga rajonet e mëposhtme:

- [Afrika, Karaibet dhe Paqësori](#)
- [Azia](#)
- [Zona e Gjirit](#)
- [Amerika Latine](#)
- [Fqinjët lindorë dhe jugorë të Bashkimit European](#)

Ndihma e jashtëme e KE jepet ose me anën e kontratave për ofrimin e shërbimeve, furnizimeve ose punës për vendet përfituese ose grantet (në përgjithësi për projektet e propozuara nga organizata jo përfituese).

a) Kontratat që ofrojnë shërbime, furnizime ose punë (tenderat)

Kontratat e Shërbimit, furnizimit dhe të punës vlerësohen pas një procesi tenderimi mbi bazën e projekteve të identifikuara nga BE në lidhje me vendet përfituese.

Lehtësia e kërimit në këtë faqe në rrjet ju lejon të shihni mundësitë aktuale dhe ato të pritshme si dhe ato afatet e fundit të të cilave tashmë kanë kaluar dhe informacion rreth kontratave të cilat janë vlerësuar për këtë (përfshi aplikantët e listës së shkurtër në rastin e një procesi të kufizuar tenderimi).

b) Grantet

Grantet janë vlerësuar për projektet e propozuara në BE nga organizatat e jashtëme (në përgjithësi, jo përfituese). Qëllimi është që projektet të përzgjidhen për grantet mbi bazën e thirrjeve për propozime.

Publikimi i një thirrje për propozime do të tregojë prioritetet përkatëse të financimit të BE, kriterin e pranueshmërisë dhe çdo kusht tjetër për vlerësimin e një granti. Lehtësia e kërimit në këtë faqe interneti ju lejon të shihni thirrjet aktuale dhe të pritshme për propozimet (si dhe skadimet e të cilave tani kanë mbaruar dhe informacion rreth granteve të cilat janë vlerësuar).

Për të gjetur informacion rreth tenderave dhe granteve Europiane ndiq hapat e mëposhtëm.

Hapi 1: futu në [faqe internet EuroNdihmë - EuropeAid](#) (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: zgjidh 'Financimi' dhe më pas 'Thirrje për njoftime propozimi & prokurimi'

Hapi 3: zgjidh 'Kërkim i Avancuar'

Hapi 4: zgjidh një lloj financimi (p.sh. një grant për një projekt ose një furnizim (mallrash), një shërbim ose punë)

zgjidh gjithashtu një rajon ose një vend

Hapi 5: kliko mbi 'kërko'

Hapi 4: Verifiko në listën e tenderave dhe thirrjeve për propozime që do të shfaqen në ekran nëse mund të gjenden disa njoftime përkatëse.

Burim informacioni 2: Komisioni European – DP Sipërmarrja dhe Industria – Hyrje në financë

Faqja e internetit: http://ec.europa.eu/contracts_grants/grants_en.htm

Si ta përdorim këtë faqe interneti?

Konsultohuni me skema të ndryshme të grantit në këtë faqe rrjeti dhe kontakto me organizatat e përshtatshme që përfshihen në kërkesat e financimit.

10.2. MUNDËSITË E TREGJEVE PUBLIKE NË BE -PROKURIMI PUBLIK NË BE

‘Cila bazë të dhënash përmban tregje publike (tenderat) e autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në Shtete Anëtare të ndryshme të BE?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, konsultohu me faqen e internetit të paraqitur më poshtë:

Burim informacioni 1: TED (Tenderat elektronikë ditorë)

Faqja e internetit: <http://ted.europa.eu/>

TED është një version elektronik i Suplementit të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Europian

Kjo faqe përditësohet çdo ditë. Të gjithë tenderat e institucioneve publike në BE me një vlerë të vlerësuar e cila është më e lartë sesa disa pragje të caktuara duhet t’u komunikohen institucioneve Europiane. Këto tendera publikohen në Suplementin e Gazetës Zyrtare të BE dhe gjithashtu publikohen në faqen e internetit të TED.

Për të gjetur informacion rreth tenderave publikë ndiqni hapat e mëposhtëm.

Hapi 1: zgjidh ‘Kërko’ ose provo opsionin “kërkim i kualifikuar”

Hapi 2: - fut një ose më shumë vende (p.sh. Gjermania)

- fut një ose më shumë tipe kontratash (p.sh. të punës, të furnizimit, kontrata shërbimi)
- fut një ose më shumë tipe procedurash (p.sh. procedurë e hapur, procedurë e kufizuar)
- fut një ose më shumë kode CPV
- përdor mundësinë për të futur fjalët kyçe të lirë në kutinë ngjitur me ‘Tekst i plotë’

Hapi 3: kliko mbi ‘kërko’

Hapi 4: konsultohu me tenderat e përzgjedhura

Burim informacioni 2: SIMAP

Faqja e internetit: <http://simap.europa.eu/>



SIMAP udhëzon përdoruesin e kësaj faqe interneti në bazat e të dhënave kombëtare në Shtetet Anëtare të BE me Informacion mbi tenderat publikë, përfshi ato me kufij më të ulët sesa nevojitet për publikim në TED.

Për të gjetur informacion rreth tenderave publikë ndiq hapat e mëposhtëm.

Hapi 1: futu në faqen e internetit SIMAP (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: zgjidh ‘Këndi i Furnitorëve – Bazat e të dhënave kombëtare të prokurimit publik’

Hapi 3: konsultohu me bazat e të dhënave të prokurimit public në Shtetet Anëtare të BE

11. Euro

11.1. Kursi i shkëmbimit të huaj Euro

11.2. Pagesat ndërkufitare në euro

11.1. EURO: KURSI I HUAJ I KËMBIMIT

‘Ku mund të gjej kursin e këmbimit të euro-s kundrejt dollarit amerikan dhe valutave të tjera?’



Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, konsultohuni me faqen e internetit të paraqitur më poshtë.

Burim informacioni: Banka Europiane Qendrore

Faqja e internetit: <http://ëëë.ecb.eu/stats/exchange/eurofxref/html/index.en.html>

Euro kurset e referimit të këmbimit të huaj mund të konsultohen në:

<http://ëëë.ecb.eu/stats/exchange/eurofxref/html/index.en.html>

Normat e referimit në këtë faqe bazohen në procedurën e bashkërendimit të rregullt ditor ndërmjet bankave qendore brenda dhe jashtë Sistemit European të Bankave Qendrore, e cila normalisht zhvillohet në 2.15 p.m. me orën ECB (CET).

11.2. Pagesat ndërkufitare në euro

‘A ka ndonjë legjislacion European mbi detyrimet për pagesat ndërkufitare në euro?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, konsultohu me faqen e internetit të paraqitur më poshtë.

Burimi i informacionit: Komisioni European – DP Tregu i Brendshëm

Faqja e internetit:

http://ec.europa.eu/internal_market/payments/crossborder/index_en.htm

Rregullorja (EC) Nr 924/2009 mbi pagesat ndërkufitare në Komunitet eliminon diferencat në detyrime për pagesat ndërkufitare dhe kombëtare në euro. Ajo aplikohet në pagesat në euro, deri në një vlerë prej EUR 50 000, në të gjitha Shtetet Anëtare. Parimi bazë është që detyrimet për veprimet e pagesës të ofruara nga një ekonomat shërbimi pagesash (p.sh. banka juaj) duhet të jee i njëjtë sido që të jetë pagesa kombëtare apo ndërkufitare.

Rregullorja zbatohet në të gjitha pagesat e kryera në mënyre elektronike, përfshi transferimet e kredisë, debitë direkte, tërheqjet kesh në bankomatet kesh (ATMs), pagesat me anën e kartave të kredisë dhe debisë, dhe dërgimin e parave.

Disa kushte mund të aplikohen në varësi të tipit të një transaksioni pagese. Për shembull, për transfertat e kredisë dhe debitë direkte, përdorimi i IBAN dhe BIC kur bëni një urdhër pagesë, është i detyrueshëm. Të gjitha Shtetet Anëtare që nuk i përkasin zonës Euro kanë mundësi të shtrijnë aplikimin e kësaj Rregullore dhe të aplikojnë taksa të njëjta për pagesat në euro si për pagesat në valutën e tyre kombëtare.

12. Informacione të tjera

12.1. Identifikimi i bar kodeve në Shtetet
Anëtare të BE

12.2. Identifikimi i Numrave Globalë të
Vendosjes (GLN)

12.1. IDENTIFIKIMI I BAR KODEVE NË SHETETET ANËTARE TE BE-së

‘Cilat standarte duhet të respektohen për krijimin e bar kodeve?’

‘Cilën organizatë duhet të kontaktojë shoqëria jonë për të marrë lejen për të nxjerrë bar kodet për t’i vendosur mbi produktet dhe ambalazhin e saj?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetje, shiko në faqen e mëposhteme të internetit.

Burim Informacioni: GS1

Faqja e internetit: <http://ëëë.gs1.org/>



Para përdorimit të identifikuesve GS1 dhe bar kodeve, është e rëndësishme të kuptojmë bazat themelore të teknologjisë. Kjo faqe interneti jep një pikënisje. Ajo prezanton konceptet bazë dhe jep çështjet kryesore që duhet të merren në konsideratë gjatë zbatimit. Organizatat Anëtare të GS1 në mbi 100 vende japin mjetet e zbatimit dhe shërbimet në zonën e tyre.

Zyra Botërore GS1 ofron bar kodin dhe mjetet e identifikimit për përdorim botëror, por është e rëndësishme të vëmë re se Organizatat Anëtare të GS1 janë mjaft të angazhuara në zbatimin e bar kodit dhe identifikimit në zonën e tyre lokale. Organizatat Anëtare ofrojnë një shkallë të gjerë shërbimesh nga mbështetja e tryezës së ndihmës, trajnimi, publikimi i standarteve/përkthimi, udhëzuesit, dhe sistemet e menaxhimit të të dhënave. Shërbimet përshtaten për nevojat lokale kështu që anëtarët duhet të kontaktojnë Organizatën e tyre Kombëtare Anëtare të GS1 për mjetet e mbështetjes vazhduese.

[kliko këtu për të gjetur Organizatën Anëtare të GS1 më afër jush.](#)

Për të gjetur informacion mbi strukturën dhe rregjistrimin e bar kodeve ndiq hapat e mëposhtëm.

Hapi 1: futu në faqen e internetit GS1 (kliko në linkun e mësipërm)

Hapi 2: zgjidh ‘[Produktet & Zgjidhjet](#)’

Hapi 3: zgjidh ‘[Bar kodet & Identifikimi](#)’



Konsultohu këtu me informacionin rreth ‘Dhjetë hapat në zbatimin e Bar Kodit’ dhe informacionin përkatës.

12.2. IDENTIFIKIMI I NUMRAVE GLOBALË TË VENDODHJES (GLN)

Si mund të marrë shoqëria ime një Numër Global të Vendodhjes (GLN) për mjediset e saj?

Për t'ju përgjigjur kësaj pyetje, shikoni faqen e internetit të paraqitur më poshtë.

Burim informacioni: GS1

Faqja e internetit: <http://ëëë.gs1.org/glnrules/>

GLN Rregullat e shpërndarjes



GLN (Numri Global i Vendndodhjes) jep zgjidhjen e serisë globale të furnizimit për identifikimin e vendndodhjeve fizike dhe organet ligjore.

Një botë reale [Historia e bordit](#) është zhvilluar për ata që duan një prezantim bazë sesi përdoren Numrat Globalë të Vendndodhjes.

Për më shumë informacion kontakt [Organizatën tënde kombëtare Anëtare të GS1](#).

[Shfaq Vështrim i Përgjithshëm i Rregullave të Shpërndarjes së GLN](#)

GLN (Numri Global i Vendndodhjes)

Me sa nënkupton emir, GLN është Çelësi i Identifikimit GS1 për Vendndodhjet. GLN mund të përdort për të identifikuar vendndodhjet fizike dhe organet ligjore ku është e nevojshme të tërhiqet një informacion paraprak për të përmirësuar rendimentin e komunikimit me zinxhirin e furnizimit. Numrat Globalë të Vendndodhjes janë një kusht paraprak për mesazhin e [GS1 eCom](#) ose për të përdorur informacionin nga [Rrjeti Global i Sinkronizimit të të Dhënave](#).

Për ndihmë në zbatimin e GLN, vizitoni faqen në rrjet [GLN Rregullat e Shpërndarjes](#).

GLN është e ndërtuar si vijon:

GS1 Prefiksi i Shoqërisë >												< Referimi kombëtar	Kontrollo Shifrat
N ₁	N ₂	N ₃	N ₄	N ₅	N ₆	N ₇	N ₈	N ₉	N ₁₀	N ₁₁	N ₁₂	N ₁₃	

GLN Zgjatimet

Numrat Globalë të Vendndodhjes mund të përdorin gjithashtu një komponent opsional zgjatimi duke përdorur Identifikuesin e Aplikimit (254) për mbështetje është i kufizuar për qëllime të brendshme. Megjithatë me zgjedhje, kur të përdoret AI (254) duhet të jetë në lidhje me AI (414) Identifikimi i një vendndodhje fizike dhe mund të kodohet duke përdorur një mbaresë EPC, një simbol GS1-128 ose një simbol i rreshtit të të dhënave GS1 (DataBar).

The GLN Extension ëill not be communicated ëith trading partners except by mutual agreement and has been developed in expectation that it ëill be an important business requirement ëith the EPC Netëork. Vendet që aktualisht kanë një GLN mund të përdorin gjithashtu një komponent vazhdues për të dalluar vendodhjet e posaçme (Vendodhje që aktualisht kanë një GLN mund të përdorin gjithashtu një komponent opsional vazhdues GLN për të dalluar vendodhjet e veçanta (hapësirat e ruajtjes, vendodhjet e portit, ruajtja në kosh, varëset kapëse, varëset, dollapi, kompartiment kompjuteri/transmetimi etj.) Megjithatë, një shoqëri mund të zgjedhë të caktojë një GLN të vetëm, pa një komponent vazhdues, si mënyrë për të identifikuar këto vendodhje.

Për një vështrim më të hollësishëm mbi përfitimet e GLN shih [GLN Përmbledhje zbatuese](#).

13. Zgjidhja e problemeve në bërjn biznes me BE

13.1. SOLVIT: një shërbim orientimi me zgjidhje për bizneset

13.1. SOLVIT: NJË SHËRBIM ORIENTIMI ME ZGJIDHJE PËR BIZNESET

‘Kush mund ta ndihmojë një shoqëri të përballojë një problem me një autoritet apo sipërmarrje kombëtare në një Shtet tjetër Anëtar përsa i përket aplikimit të saktë të rregullave të tregut të brendshëm?’

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetjeje, shikoni faqen e mëposhtëme të internetit.

Burim informacioni: SOLVIT

Faqja e internetit: <http://ec.europa.eu/solvit>



ÇFARË ËSHTË SOLVIT?

SOLVIT është një rrjet që jep zgjidhje të problemit online në të cilin shtetet anëtare të BE punojnë së bashku për të zgjidhur problemet që dalin nga keqaplikimi i legjislacionit të BE nga autoritetet publike. Ekziston një qendër SOVIT në çdo shtet anëtar të BE (si edhe në Norvegji, Islandë dhe Lituani). Qendrat SOLVIT mund të ndihmojnë me trajtimin e ankesave të bizneseve dhe qytetarëve. Ata janë pjesë e administratorëve kombëtarë dhe janë të angazhuar me dhënien e zgjidhjeve reale të problemeve brenda dhjetë javëve. Përdorimi i SOLVIT është pa pagesë.

Për informacion të mëtejshëm në të gjitha gjuhët e BE-së, ju lutemi të vizitoni faqen e internetit të SOLVIT

Kë ka ndihmuar ai deri tani?

Disa shembuj sesi SOLVIT ka ndihmuar biznese dhe qytetarë mund të gjenden në adresën: http://ec.europa.eu/solvit/site/success/index_en.htm.

Qendrat Kombëtare SOLVIT mund të kontaktohen nëpërmjet faqes së mëposhtëme të internetit: http://ec.europa.eu/solvit/site/centres/index_en.htm

14. KONTAKT

Rrjeti i Informimit i Bashkimit European per Biznesin

Zyra Qendrore, Bashkimi i Dhomave te Tregtise dhe Industrise e Shqiperise

Blv. Zhan D'Ark, 23

Tirana

<http://eubusinessrelay.al>

Rrjeti i Informimit i Bashkimit European per Biznesin - Fier

Tel&Fax: + 355 34 502 514

E-mail: cciqarkufier@yahoo.com

Adresa: Dhoma e Tregtise dhe Industrise Fier

Lagja: "Kastriot", Rruga: "Leon Rei"

Fier-Albania

Rrjeti i Informimit i Bashkimit European per Biznesin - Gjirokaster

Tel :++355 08 426 8001

Mobile: ++355 68 40 58 777

E-mail: ccigjirokaster@gmail.com

Adresa: Dhoma e Tregtise dhe Industrise Gjirokaster

Lagjia "18 Shtatori",

Gjirokaster-Albania

Rrjeti i Informimit i Bashkimit European per Biznesin - Lezhe

Tel&Fax: 0215 22 332/0215 22 235

E-mail: dhti_lezhe@yahoo.com

Adresa: Dhoma e Tregtise dhe Industrise Lezhe

Sheshi "Gjergj Kastrioti"

Lezhe- Albania

Rrjeti i Informimit i Bashkimit European per Biznesin - Durres

Tel: 052 222 199

Mobile: 068 20 88 566

E-mail: info@ccidr.al

Adresa: Dhoma e Tregtise dhe Industrise Durres

Lagjia 3, Rruga "Skenderbeg",

Durres - Albania